



*Vetëllogaria*  
**PARIM I TË SINQERTËVE**



# Revista Drita Islame në versionin online...

www.dritaislame.al



TEOLOGJI

BOTA JONË

REFLEKSIONE

TRASHËGIMI KULTURORE

FAMILJA

PERSONALITETE



www.dritaislame.al

"Drita islame"  
Botim i Komunitetit Mysliman  
të Shqipërisë

DREJTOR  
Dorian Demetja

KRYEREDAKTOR  
Mehmet Disha

REDAKTOR  
Andrin Rasha

DIZAJNI DHE FAQOSJA  
Ejup Lila

KONTAKT:  
Tel/fax 04 223 04 092  
E-mail: info@dritaislame.al

Viti XXXI i botimit  
Nr. 12 (475)  
Dhjetor, 2022

ISSN 2226-7115



Artikujt  
që vijnë në redaksi  
dhe botohen,

nuk paraqesin domosdoshmërisht  
edhe pikëpamjet e revistës.

Materialet e sjella në redaksi,  
pavarësisht nëse botohen apo jo,  
nuk i kthehen autorit.



## PËRMBAJTJA

4 Vetëllogaria, parim i të sinqertëve / Mehmet Disha

6 Me Zotin mes njerëzve / Dorian Demetja

8 Lajme / Aktivitete



12 Arti dhe kaligrafia e gjuhës arabe / H. Bujar Spahiu

14 Shërimi i brengave dhe problemeve nën hijen e Kur'anit dhe Sunetit / Dr. Abdullah el Hatir

18 Ftesa, thirrja për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij / Shkëputur nga "Jeta e Sahabëve 1", botim i KMSH

22 Largësia nga libri, anormalitet i normalizuar / Nuredin Nazarko

24 Lutja dhe vetëdija e ihsanit të Profeti a.s. / Elton Karaj

28 Lindja e Profetit / Retrospektivë



32 Xhavit Alimehmeti (1929-1997) / Xhemal Balla

34 Sinqeriteti, zburkuesi i martesës / Aisa Kokiqi

36 Nenexhiku dhe vetitë e tij pozitive për shëndetin / Fatih Altun

38 Omeri bujar / Hapësirë femërore



# *Vetëllogaria* **PARIM I TË SINQERTËVE**



Ikja e shpejtë e kohës dhe vrulli i nxituar i kësaj epoke duhet të na rikthejë përherë e më shumë drejt parimeve të pastra të myslimanit. Kjo për arsye se kriteret e Kur'anit dhe të Sunetit Profetik, janë strehë e shpëtimit nga të këqiat e këtij vrulli. Myslimani, në fundin e një dite, të një jave, a të muajit apo tekefundit, në përfundimin e një viti, duhet që të bëjë një vetëllogaritje për të parë se si po ecin gjërat në raport me fitimin e kënaqësisë së Allahut xh.sh.

Vërtet, janë një sërë zgjedhjesh e gabimesh që ne i bëjmë gjatë përditshmërisë e që pas njëfarë kohe ato na reflektohen mbrapsht duke na vënë në pah mangësitë. Këto gabime duhet që të kihen parasysh në mënyrë që të mos ripërsëriten, e që llogaria e tyre të mos mbetet për në botën tjetër.

Allahu thotë: "Në ditën e gjykimit Ne do të vëmë peshoja të drejta, e askujt nuk i bëhet e padrejtë asgjë, edhe nëse është (vepra) sa peshoja e një kokrrë të melit Ne do ta sjellim atë. E mjafton që Ne jemi llogaritës". Kuran, 21:47.

Allahu gjithashtu thotë: "...le të shikojë njeriu se çka ka bërë për nesër..." (Kuran 59:18)

Besimtarët e besimtare e drejta janë gjithmonë plotësisht të vetëdijshëm që kanë ardhur në këtë botë për të mbartur një premtim (marrëveshje) shpirtërore që rezulton ose në fitim ose në humbje, që në terma tjerë është ose Xheneti ose Xhehenemi. Është njeri i urtë ai i cili përpiket në adhurim dhe i thotë shpirtit të tij: "O shpirti im, ti ke vetëm një jetë; asnjë moment të vetëm që të ka kaluar nuk mund të rikthehet, numri i frymëmarrjeve të tua që të jepen nga Allahu, janë të caktuara, dhe nuk mund të shtohen. Kur të mbarojë jeta, nuk mund të veprosh më asnjë vepër të mirë, prandaj atë që duhet ta bësh, bëje tani."

Në Ditën e Ringjalljes, njeriut do t'i shpalosen të gjitha veprat e bëra dhe do të gjykohet në bazë të tyre. Kështu seritë e tëra të orëve të jetës së njeriut do të shfaqen, një nga një, para shikimit të tij. Prandaj duhet t'i themi shpirtit çdo mëngjes, "Allahu ju ka dhënë njëzet e katër thesare, kini mendjen të mos ju humbasin ndonjëra prej tyre, që të mos jeni në gjendje të duroni keqardhjen që do t'iu vijë nga humbjet e tilla."

### **Përkujtimi i Allahut**

Njeriu duhet t'i rikujtojë vetes sa herë që Allahu vëzhgon të gjitha veprat dhe mendimet e tij. Njerëzit shohin vetëm jashtë, ndërsa Allahu e sheh njeriun si në pamjen e jashtme ashtu edhe në atë të brendshmen.

Abdullah Ibn Dinari tregon: "Isha duke ecur njëherë me halifin Omer afër Mekës, kur u takuam me një djalë skllav-bari që ishte me kopenë e tij. Omeri i tha atij: "Më shit një dele." Djali u përgjigj:

"Nuk janë të mijat, por të padronit tim." Pastaj, për ta vënë në provë, Omeri i tha: "Ma shit mua dhe padronit thuaj që e hëngri ujku." Bariu, i çuditur nga kjo kërkesë i tha: "Po Zotit të padronit, çfarë t'i them Ditën e Kijametit?!" Omeri u ul në gjunjë dhe filloi të qajë nga këto fjalë, pastaj e bleu atë rob dhe e liroi. Ai i tha bariut: "Për këtë thënie ju jeni i lirë në këtë botë dhe do të jeni i lirë në botën tjetër."

Ditën e Llogarisë do të pyetesh për secilën vepër që ke vepruar, pyetja e parë: "pse e ke bërë këtë vepër?", e dyta: "në çfarë mënyre e ke bërë këtë?", dhe e treta: "për çfarë qëllimi e ke bërë atë vepër?".


Pyetja e parë do të kërkohet për shkak se njeriu duhet të veprojë sipas udhëzimit hyjnor, e jo nga ndikimi njerëzor e djallëzor. Nëse kjo pyetje është përgjigjur kënaqshëm, pyetja e dytë do të provojë se në çfarë mënyre veprimi e ke bërë, me mençuri, apo me shkujdesje dhe neglizhencë, dhe pyetja e tretë, nëse është bërë thjesht për të kënaqur Allahun, apo për të fituar kënaqësinë e njerëzve. Nëse një njeri kupton kuptimin e këtyre pyetjeve, ai do të jetë shumë vigjilent mbi gjendjen e zemrës së tij.

Njeriu duhet të meditojë në mënyrë rigorozë se do të japë llogari për veprimet e tij që i ka bërë. Çdo mbrëmje ai duhet të shqyrtojë zemrën e tij për atë që ai ka bërë për të parë nëse ka fituar ose ka humbur në kapitalin e tij shpirtëror. Kjo është më se e nevojshme, ngasenefsi është gjithnjë i gatshëm të miklojë e të mashtrojë, ndonjëherë ai paraqet egoizmin e vet nën maskën e bindjes ndaj Allahut, në mënyrë që ti mendon se ke fituar, kur në realitet ke humbur.

Një njeri i drejtë me emrin Amija, gjashtëdhjetë vjeç, llogaritte ditët e jetës së tij. Ai numëroi 21.600 ditë. Ai tha me vete, "Sa keq! Nëse unë kam kryer një mëkat çdo ditë, si mund të shpëtojnë nga ngarkesa e 21.600 mëkateve?" Ai nxori një britmë dhe ra për tokë, kur erdhën për ta ngritur atë, e gjetën të vdekur.

Por shumica e njerëzve janë të pavëmendshëm, dhe kurrë nuk mendojnë për llogarinë e vetes. Njerëzit llogarisin në tespihët (rruzat) e tyre me vetë-kënaqësi numrin se sa herë kanë përmendur emrin e Allahut, dhe harrojnë të llogarisin fjalët e panumërta të kota që flasin.

Së fundmi, nëse ndonjëri e gjen veten neglizhent dhe jo të prirur që të jetë serioz në procesin e vetë-disiplinës dhe vetëllogarisë, duhet të shoqërohet me atë që është i aftë në praktika të tilla në mënyrë që të rrisë entuziazmin e tij. Një njeri i drejtë kishte thënë: "Kur më rritet pasiviteti në vetë-disiplinë, unë shoh Muhamed Ibn Uasin, dhe sytë e tij rindezin te unë entuziazmin tim për të paktën një javë."



سُورَةُ هُودٍ  
 وَإِنْ يَمْسَسْكَ اللَّهُ يَضْرِبْكَ فَلَإِنَّكَ تَكْشِفُ لَهُ  
 وَإِنْ يَشَاءْ يُصِيبْ بِهِ مَن يَشَاءُ  
 قُلْ يَأْتِيهَا النَّاسُ قَدْ جَاءَ كُفْرًا  
 وَهُوَ أَلْفُ عَشْرٍ  
 وَالْحَقُّ مِن رَّبِّكُمْ  
 فَمَن أَهْتَدَى فَأَنَّمَا يَهْتَدِي لِنَفْسِهِ  
 ضَلَّ فَإِنَّمَا يَضِلُّ عَلَيْهَا وَمَا أَنَا عَلَيْكُمْ بِوَكِيلٍ  
 مَا يُوحَىٰ إِلَيْكَ وَأَصْدِرْ حَتَّىٰ يَخُفَّكَ اللَّهُ  
 وَهُوَ خَيْرٌ  
 سُبْحَانَ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ  
 بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ  
 الرَّكْبُ أَحْكَمَتْ آيَاتُهُ ثُمَّ فُصِّلَتْ  
 الْآلَاءُ لِيُبَيِّنَ لَكُمْ قِيَامَ ذِكْرِهِ  
 وَتُؤْتُوا إِلَيْهِ يَمْتَعِكُمْ  
 كُلِّ ذِي فَضْلٍ فَضْلَهُ وَإِن تَوَلَّوْا  
 كَبِيرٌ  
 إِلَى اللَّهِ مَرْجِعُ  
 يَنْتَوْنُ صُدُورُهُمْ  
 يَعْلَمُ مَا يَسِرُّوْنَ

*Me Zotin  
 mes njerëzve*

Krijuesi i Lartë, ekzistenca e të cilit është shkaku i ekzistencës sonë, i ka rrethuar gjithë botët me madhësitinë e Tij. Qiejt dhe toka janë nga një përshndritje prej rrezatimeve të nurit të Tij. Ai është altari i amshuar i shpirtrave të përkryer që e kanë gjetur të vërtetën. Ai është e vetmja kible, i vetmi orientim. Ta lësh Atë për të vrapuar te dikush tjetër, është marrëzi, t'ia qash hallet dikujt tjetër veç Atij, një vetëmashtrim. Ata që largohen prej portës së Tij, pësojnë disfatë të madhe dhe mbeten në rrugë, zemrat që nuk ndriçohen dot me dritën e Tij, ndjekin iluzionin optik në shkretëtirë dhe lodhen më kot. Meqë feja e Allahut është e përhershme dhe Hz. Muhamedi (a.s.) është profeti i fundit, pas vdekjes së tij kujt do t'i takonte detyra për njoftimin e së vërtetës me fjalë dhe vepra, për ta jetuar e për ta mbajtur të gjallë atë? Çdo të bëhej pas perëndimit të këtij dielli nga rruzulli tokësor drejt botës së përjetshme? Nuk ka dyshim se kjo detyrë e shenjtë u përket njerëzve të fesë në veçanti dhe të gjithë myslimanëve në përgjithësi. Favori më i madh i Allahut, i Cili na bën të rrojmë në mes të mirave të pafundme, është përgjegjësia e amanetit që shprehet në "Kuran": "Kështu, Ne ju kemi bërë një bashkësi të drejtë, që të bëheni dëshmitarë përmbi njerëzit dhe që i Dërguari i Allahut të jetë dëshmitarë përmbi ju." 1

Të gjitha dituritë fillojnë nga dëshmia e njëshmërisë së Zotit. Të gjitha meritat e krijimtarive dhe të egos primare i takojnë Allahut. Kjo është dituria reale dhe nuk pranon marrëveshje, konsensus. Pas kësaj vjen raporti që ka besimtarin me Profetin Muhamed (a.s.). Sa pjesë është ai te Profeti dhe sa pjesë është profeti tek ai. Sot dhe përherë kemi nevojë për njerëz që përpara fjalëve t'u flasin veprat, ashtu si bënë shokët e Profetit. Dhe jo për njerëz që i kushtojnë më shumë rëndësi aparençës, që vetëm dinë të flasin bukur e të bëjnë një diplomaci të mirë. Pikë së pari nga ne kërkohet të mendojmë, gjykojmë dhe të punojmë bukur, në përputhshmëri të plotë me kënaqësinë e Zotit. Dhe së dyti, të gjitha mjetet që do të përdorim drejt këtij qëllimi parësor, duhet të mos bien në kundërshtim me dispozitat islame. Vetëm atëherë do të kemi mirësinë dhe begatinë nga i Madhi Zot për të qenë të suksesshëm në punët tona.

Është i çuditshëm fakti që sa herë që njeriu bën përpara në rrugën drejt Zotit, djalli menjëherë reagon duke e sulmuar atë nga dobësitë e tij. Duke i njohur shumë mirë dobësitë e secilit, djalli vepron me dredhi për ta rrëzuar njeriun, madje kur përpiqet për këtë, dëshiron që ky rrëzim të jetë i fortë. Dredhitë e tij janë nga më të ndryshmet, sidomos kur luan me një kartë shumë të rrezikshme, siç është pesimizmi. Në çdo rrëzim që i bën, djalli sikur dëshiron t'i thotë njeriut që të dorëzohet; ai lë imazhin e vështirësisë dhe të pamundësisë së mbarimit të kësaj rruge.

Jeta që Zoti i ka dhënë njeriut në këtë botë është amanet. Prandaj njeriu këtë amanet duhet ta çojë në vendin e vet, duke u bërë rob i Zotit në kuptimin e plotë të fjalës. Gjithë jetën e vet, një mysliman i mirë përpiqet për të qenë një besimtar i denjë për Krijuesin. Shprehja e Profetit (a.s.): "Feja është këshillë"<sup>2</sup>, do të thotë se feja është sinqeritet, ajo çfarë shpreh zemra, jo buzët. Këshilla jo vetëm që është prej feje, por është detyrë dhe mision i profetëve, të cilët ishin dërguar t'ua tërhiqnin vëmendjen njerëzve duke i ftuar në adhurimin e sinqertë vetëm Allahut. Themi kështu, pasi njeriun e ndjekin nga pas shumë dëshira e pasione dhe, duke pasur parasysh fjalën e Zotit që njeriu është krijuar i dobët, ai shumë shpejt dhe shumë lehtë mund të bjerë në kurthin e kësaj bote. Në këtë mënyrë ai mund të bëhet rob i parasë, i postit, i famës, i pasioneve, i epshit etj. Çdo njeri ka dobësitë e veta dhe askush nuk mund ta refuzojë këtë, sepse kjo na bën të jemi njerëz të gabueshëm. Ajo që kërkohet prej nesh pas besimit, është të formojmë dhe të ndërtojmë mekanizmat e duhur për të ecur pa lëkundje në rrugën drejt Zotit. Kjo natyrisht duhet të shoqërohet me lutje e përgjërime ndaj Krijuesit që të na ndihmojë në rrugëtimin tonë drejt përmirësimit. Sigurisht rruga që të çon në xhenet është e gjatë, e lodhshme, me sakrificë pa fund... Ndërsa e kundërta ndodh me rrugën që të çon në xhehenem; ajo është si një autostradë pa pengesa, ku përbri gjen lëndina e mjedise të bukura. Aty shikon bukurinë dhe ngjyrat e natyrës që të bëjnë për vete.

"Kurani" i afrohet njeriut në të gjitha drejtimet si një i gjithi, duke iu referuar mendjes, zemrës, ndjenjave, emocioneve, që njerëzit me natyrë dhe karakter të ndryshëm ta marrin mesazhin hyjnor nga rruga e krijimit të tyre. Sot, për hir të Allahut është një punë për t'u bërë në vlerën e të gjithë botëve. Kjo punë është që botës t'ia bëjmë të njohur Allahun dhe t'i tregojmë për profetin Muhamed (a.s.). Atëherë le t'i lëmë pretendimet e mëdha, fjalët boshe dhe të përpiqemi për të përmbushur këtë detyrë fisnike. Të kërkojmë dhe të gjejmë rrugët që fenë tonë ta përcjellim tek të tjerët në mënyrën më të drejtë. Këto të vërteta të çmueshme që Allahu na dhuroi, vallë si mund t'ia përcjellim fëmijëve, të rinjve, grave, burrave, gjithë botës?! Ky është dhe duhet të jetë preokupimi ynë.

Si rrjedhojë, gjithmonë çështja më e rëndësishme te myslimanët është edhe një herë rizgimi i shpirtit islam, rizgimi i shpirtit të fesë. Kur do të harrohet vetvetja dhe do të mendohet lumturia e përhershme njerëzore?! Nëse ne kujtojmë dhe jetojmë vetëm për veten tonë, atëherë nuk mund të kujtojmë atë që duhet. A mos vallë nuk na shkatërrojnë ne, grupet e njerëzve që mendojnë vetëm për veten e tyre?!

1. Bekare, 2:143

2. Muslim



## 1

## KRYETARI I KOMUNITETIT MYSLIMAN TË SHQIPËRISË, H. BUJAR SPAHIU, UDHËTOI PËR NË MBRETËRINË E BAHREINIT: "LINDJA DHE PERËNDIMI PËR BASHKËJETESËN NJERËZORE".

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, udhëtoi për në Mbretërinë e Bahreinit, ku me ftesë zyrtare të Abdurrahman bin Muhamed bin Rashid Al Khalifa, Kryetar i Këshillit Suprem për Çështjet Islame, mori pjesë në forumin e organizuar nga ky institucion, me titull: "Lindja dhe perëndimi për bashkëjetesën njerëzore".

Ky aktivitet u zhvillua për herë të parë në Mbretërinë e Bahreinit, nën kujdesin e veçantë të Shkëlqesisë së Tij, Hamad bin Isa Al Khalifa, Mbretit të Bahreinit.

Pjesë e këtij organizimi ndërkombëtar ishin studiues, personalitete politike dhe liderë fetarë nga e gjithë bota, ndër ta edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu dhe z. Sami Shiba, Ambasadori i Shqipërisë në Arabinë Saudite.

Qëllimi kryesor i këtij forumi, i cili u zhvillua në Mbretërinë e Bahreinit, mes datave 3 dhe 4 Nëntor 2022, ishte adresimi dhe zgjidhja e problematikave prej të cilave vuan shoqëria njerëzore sot.

Të pranishëm në sesionin përmbyllës të forumit, ishin vetë Mbreti i Bahreinit, Hamad bin Isa al Khalifa, Shejhul Al-Az'harit, Ahmed al-Tajib dhe Papa Françesku i Vatikanit.







## 2

**KRYETARI H. BUJAR SPAHIU PJESË E FORUMIT ME TEMË: "GLOBALIZMI I KONFLIKTEVE DHE UNIVERSALIZMI I PAQES: KËRKESAT DHE PARTNERITETET" NË ABU DHABI**

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, udhëtoi për në Abu Dabi të Emirateve të Bashkuara Arabe, ku me ftesë zyrtare të Shkëlqesisë së tij Abdullah bin el-Shejkh el-Mahfudh bin Bejah, Kryetar i Forumit të Abu Dabit për Paqen dhe Kryetar i Këshillit të Emirateve për Fetvanë, po merr pjesë në forumin e organizuar nga ky institucion, me temë: "Globalizmi i Konfliktive dhe Universalizmi i Paqes: Kërkesat dhe Partneritetet".

Ky aktivitet zhvillohet nën kujdesin e veçantë të Shkëlqesisë së Tij, Abdullah bin Zajed al-Nahjan, Ministër për Punët e Jashtme dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar në EBA.

Gjatë punimeve të këtij forumi 3-ditor, 8-10 nëntor, z. Spahiu, krahas pjesëmarrjes në sesionet e tij, po zhvillon njëkohësisht edhe takime me krerët më të rëndësishëm fetarë islamë të Lindjes së Mesme dhe më gjerë, si dr. Abdullah bin Bejah, kryetar i Forumit, dr. Muhamed bin Abdulkarim el-Isa, Sekretar i Përgjithshëm i Ligës së Botës Islame, etj.

Gjatë qëndrimit në Abu Dabi, Kryetari i KMSH-së, H. Bujar Spahiu, u takua me H.E. Ali Rashid Al Nuaimi, Kryetar i Këshillit Botëror të Komuniteteve Myslimane.

Në takim, Kryetari Spahiu u shoqërua nga këshilltari për marrëdhëniet me vendet arabe, z. Jamal al-Safarti.





## 3

### ZHVILLOHET SIMPOZIUMI ME TEMË: "BASHKËJETESA FETARE - TRADITË DHE KULTURË NË TIRANË"

Ky simpozium, i zhvilluar me datë 15.11.2022 në ambientet e "Tirana International Hotel", vjen në kuadër të promovimit të botimit "Guidë Turistike Fetare për Tiranën", botim ky i Qendrës për Administrim Social Ekonomik Territorial në bashkëpunim me Bashkinë e Tiranës.

Kjo guidë fetare, synon përmbledhjen dhe prezantimin e objekteve të kultit më të veçanta e më të pasura fetarisht e kulturalisht që mbart Tirana nga të 5-ta komunitetet fetare, si dhe percjellja e këtyre vlerave për të gjithë të huajt që vizitojnë Tiranën.

Të pranishëm ishin përfaqësuesit e 5 besimeve fetare të vendit tonë, ndër ta edhe Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, Nënkryetari i Bashkisë Tiranë, z. Andi Seferi, Kryetari i Komitetit Shtetëror për Kultet, z. Klodjan Bulku, studiues, akademikë, klerikë, agjentë turistik, besimtarë, etj.

Kryetari Spahiu, ndau me të pranishmit shembullin e bashkëjetesës fetare që karakterizon vendin tonë. Sipas tij, takimet, forumet apo aktivitetet e nivelit të lartë kombëtar e ndërkombëtar, janë tregues të qartë që flasin për vëllazërinë njerëzore. Më tej ai u ndal edhe në domethënien e këtij botimi për objektet e kultit.

Ky simpozium vijoi më tej me fjalët e përfaqësuesve të tjerë të komuniteteve fetare, të cilët gjithashtu vlerësuan punën e bërë në kontekstin e mbledhjes dhe promovimit të objekteve të kultit me anë të këtij botimi, për të gjithë ata që shfaqin interes në vlerat tona të bashkëjetesës ndër-fetare.





## 4

### VIZITË NGA NJË DELEGACION I BASHKËSISË ISLAME TË KOSOVËS

Kryetari i KMSH, H. Bujar Spahiu, priti për vizitë një delegacion nga Bashkësia Islame e Kosovës dhe Bashkësia Islame e Maqedonisë së Veriut, me përfaqësues z. Ramadan Shkodra dhe prof. Jusuf Zimeri.

Përveç projekteve të përbashkëta në të ardhmen, biseda në këtë vizitë u fokusua në përmbylljen e punës disa vjeçare të veprës "El-Ihtijar li Ta'lilil Muhtar", vepër e cila është përkthyer dhe redaktuar në bashkëpunim me të tre Komunitetet Myslimane (Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Bashkësia Islame e Kosovës dhe Bashkësia Islame e Maqedonisë së Veriut).

Pas Kolanës "Zani i Naltë" dhe librit "Ilmihal i zgjeruar", vepra në fjalë me 4 vëllime në fushën e Fikhut Hanefi, është projekti më i madh i të tre Komuniteteve respektive. Kryetari u shoqërua në këtë takim nga Drejtori i Kulturës, z. Dorian Demetja.

## 5

### KRYETARI I KMSH H. BUJAR SPAHIU, PRITI NË NJË VIZITË DREJTORËT E MEDRESEVE

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H. Bujar Spahiu, priti në një vizitë titullarët e medreseve të vendit, përkatësisht z. Ndrëçim Gjimi, Drejtor i Medresesë Tiranë, z. Kujtim Dervishi, Drejtor i Medresesë Shkodër, znj. Neriman Gjinali, Drejtoreshë e Medresesë Durrës dhe z. Ardit Dragoti, Drejtor i Medresesë Elbasan.

Ky takim vjen në kuadër të vlerësimit me çertifikatë të nxënësve maturante të medreseve të cilët kanë hyrë në kategorinë e ekselencës, duke fituar kështu medalje të artë të dhënë nga Kryeministria e Shtetit Shqiptar për vitin 2022.

Prezentë në këtë takim, në selinë e KMSH-së, ishin edhe vetë studentet e lartpërmendura, të cilat u vlerësuan me çertifikatë dhe një vlerë financiare simbolike.

Në fjalën e tij, Kryetari Spahiu, u shpreh krenar me arritjet e nxënësve të medreseve, duke theksuar kontributin e stafit pedagogjik. Ndërsa drejtuesit e medreseve të pranishëm në këtë takim shprehën falenderimet e tyre për organizimin e kësaj pritjeje. Në fjalën e tyre ata vlerësuan faktin që KMSH u kushton një rëndësi të veçantë dhe i mbështet vazhdimisht këto institucione arsimi. Nxënëset fituese të medaljeve të arta i përkasin dy Medresesë së Tiranës dhe një Medresesë së Durrësit.



# Arti dhe kaligrafia E GJUHËS ARABE

Kurani, si në aspektin e stilit të lartë letrar si libër hyjnor me dinamizmin e tij që depërton në zemrat e njerëzve, është një ndër librat themelorë qiellorë që ka ndikuar shumë dhe ka lënë gjurmë në ndjenjat, estetikën dhe artin islam.

Rrënjët e artit islam bazohen dhe burojnë nga Kurani Famëlartë dhe Suneti (Tradita) i profetit Muhamed. Profeti ka thënë: "Me të vërtetë Allahu është i bukur dhe e do të bukurën".

Arti është një nga rrugët më të rëndësishme që bën të zhvillohet shpirti dhe ndjenjat e përparimit, arti është çelës magjik që zbulon dhe hap thesaret e fshehta. Pas dyerve të hapura me të idetë veshin rrobën e trajtës, kurse iluzionet pothuajse trupëzohen.

Arti vjen në krye të faktorëve, që me ruajtjen e botës ndiesore të njeriut, duke i treguar për çdo rast asaj bote më të lartën e synimeve, i shtyn shpirtat që të ndiejnë nga thellësia në thellësi. Sikur të mos ekzistonte arti në botën e ndërhyrjes dhe zbulimit të njeriut atëherë nuk do të kishim mundësi të shihnim asnjëherë prej bukurive që ekzistojnë aktualisht. Dhe ata shpirta artistë të zjarrtë do të propozeshin në tokë për të humbur me gjithë projektet, planet dhe përfytyrimet e tyre. Prandaj arti është një tablo që i përshkruan njeriut thellësinë e botës së brendshme, dhe në saje të tij ndjenjat dhe mendimet më të thella, konstatimet më të çuditshme dhe dëshirat më intime janë regjistruar në një plan dhe pothuajse janë bërë të pavdekshme.

A nuk ishte si rrjedhojë e shoqërimit të besimit prej

artit që kjo botë madhështore, me faltoret e saj të ngritura, me minaret si gishta dëshmie që tregojnë botën e përtejme, dhe me motivet e dizajnet e bekuara, me artin e shumëllojshëm të shkrimit dhe me punimet dhe qëndisimat e bukura kjo botë madhështore, pra që shndërruar në një galeri bukurish që nuk ngopesh së pari. Gjallëria e dhuntive njerëzore ka shumë lidhje me shpirtin e artit. Nuk ka dyshim se interesimi dhe konsiderata për një vepër arti i përkasin, më tepër se sa vetë veprës, mjeshhtërisë dhe artit në shpirtin e saj.

Është arti që e bën hekurin më të çmuar se arin, bakrin se bronzin, sigurisht në saje të artit, mineralet më të pavlefshme shndërrohen në gjëra më të çmuara se ari, argjendi dhe diamanti, pra të gjitha artet e bukura në vijën tonë të të menduarit, janë dhurata të pavdekshme të shpirtit të bekuar artistikë për njerëzimin.

Gjuha arabe është një ndër faktorët kryesorë që bashkoi shumë popuj në një qytetërim që u edukua e u frymëzua nga Kurani. Alfabeti arab u bë kështu për popujt vendas myslimanë njësoj siç u bë alfabeti latin për popujt e krishterë të Perëndimit. Por ndryshimi mes gjuhës latine dhe asaj arabe është se shkrimi arab nis nga e djathta në të majtë. Shkrimtarët arabë përdornin si mjete shkrimi pena të kuqe (kalem) ose furça të posaçme për të shkruar. Po të flasim në përgjithësi, në shekujt e parë të Islamit ka pasur dy lloje të dallueshme shkrimi: kursi dhe kufij. Në shek. XI shkrimi kufij doli nga përdorimi, duke u zëvendësuar nga një lloj i ri shkrimi i quajtur nas'hi që u përdor gjerësisht në kopjimin e Kuranit dhe që ishte ndoshta shkrimi më i përhapur në



botën arabe. Shkrime të dallueshme u zhvilluan në rajone të veçanta. Në Spanjë shkrimi magribi (perëndimor), u zhvillua dhe u bë shkrimi standard për Kuranin në Afrikën Veriore. Një kontribut të veçantë për kaligrafinë arabe dhanë Persia dhe Turqia. Këta dy popuj adoptuan alfabetin arab për gjuhët e tyre, dhe kjo i mundësoi atyre zhvillimin e kaligrafisë dhe artit, ku u krijua shkrimi taliki tek persianët dhe ai divani tek turqit.

Me gjithë vështirësinë e shkrimit dhe vështirësitë në të lexuar, një gjë e veçantë në kaligrafi është edhe tugra osmane me një kompozim të ndërlikuar. Në kaligrafinë arabe shfaqet një profesionalizëm i mirëfilltë ku përveç pergamenave, papiruseve dhe letrës i gjen të shkruara në gur, mure, pllaka qeramike, në shami dhe objekte monumentale.

Në shek. XVII u përhap jashtë mase shkrimi osman divani i cili pëlqej shumë nga kancelaritet osmane dhe përdorej dendur për qëllime dekorative. Shkrimi hurr është shkrimi më i ri kaligrafik i kohëve tona që u zhvillua në pjesë të ndryshme të botës arabe gjatë viteve '80 të shekullit të kaluar, i vlerësuar si elegant dhe shumë i stilizuar.

Shkrimi kufij është triumfues i kohërave të hershme të Islamit. Ai u krijua pas themelimit të dy qyteteve myslimane të Basras dhe të Kufes në Irakun e sotëm në dhjetëvjeçarin e dytë të shek. I hixhri. Ky shkrim ka masa specifike të përpjesëshme, së bashku me kënde të theksuara dhe forma katrore. Ai u bë i njohur si el-hat el-kufij. Shkrimi kufij pati një ndikim të thellë në të gjithë kaligrafinë dhe artin islam.

Shkrimi nas'hi është një nga shkrimet e hershme që u zhvillua në botën islame. Ai pati një ndikim të madh në popull dhe stili i tij paraqet një linjë me të vërtetë ritmike, ku më vonë u reformua në një shkrim estetik të pranueshëm për Kuranin Famëlartë, i cili ishte i lehtë në të shkruar e në të lexuar. Shkrimi rika ose rukah (faqe e vogël) është rrjedhojë e shkrimit nas'hi dhe thuluthi dhe është më i thjeshtuar. Ai u pëlqye shumë nga kaligrafët osmanë.

Shkrimi talik (i varur) mendohet të jetë zhvilluar nga persianët nga një shkrim i vogël i hershëm arab i quajtur Firamuz. Taliku, që njihet gjithashtu edhe si farisi, është një shkrim i thjeshtë kursiv që me sa duket është në përdorim qysh nga fillimi i shek. IX. Kaligrafi Abdul-Haj nga qyteti i Astarabadit, duket se ka luajtur një rol të rëndësishëm në përpunimet e hershme të këtij shkrimi. Ai u nxit nga patroni i tij Sheh Ismaili që të formulojë rregullat themelore të shkrimit talik. Ky shkrim edhe sot parapëlqehet shumë nga arabët dhe është stili kaligrafik autokton ndërmjet myslimanëve turq, persianë dhe indianë.


Mir Ali Sulltan Tabrizi përpunoi nga shkrimi talik një tjetër lloj shkrimi më të lehtë dhe elegant, i cili u bë i njohur nën emërtimin nastalik. Fjala nastalik është një kompozitë që rrjedh nga fjalët nas'h dhe talik. Megjithatë kaligrafët turq dhe persianë vazhduan të përdorin talikun si një shkrim monumental në raste të rëndësishme. Shkrimet talik dhe nastalik janë përdorur gjerësisht për kopjimin e antologjive poetike persiane, këngët epike, në miniaturat dhe në punimet letrare, por jo për kopjimin e Kuranit Famëlartë.



وَالْأَرْضُ مَرْحَمَةٌ وَإِنَّا لَمَرْحَمَةٌ لِلَّذِينَ هُمْ عَلَىٰهَا حَاكِمُونَ ﴿١٧٧﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٧٨﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٧٩﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٨٠﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٨١﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٨٢﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٨٣﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٨٤﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٨٥﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٨٦﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٨٧﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٨٨﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٨٩﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٩٠﴾

وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٩١﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٩٢﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٩٣﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٩٤﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٩٥﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٩٦﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٩٧﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٩٨﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿١٩٩﴾  
 وَاللَّهُ يَتَذَكَّرُ الْعَبِيدَ ﴿٢٠٠﴾





# SHËRIMI I BRENGAVE DHE PROBLEMEVE NËN HIJEN E KUR'ANIT DHE SUNETIT

## Çfarë synojmë me shërim?

Kur'ani dhe Suneti posedojnë ilaç për shërimin e pikëllimit dhe brengave, sidomos nëse ato janë shkaktuar nga faktorë të jashtëm. Ky është imazh i mëshirës së Allahut të Madhëruar ndaj robërve të Tij, ngase Kur'anin e bëri shërim dhe mëshirë për besimtarët, ndërsa këtyre të fundit nuk iu mbetet gjë tjetër pos të kthehen kah Kur'ani dhe Suneti i Pejgamberit a.s., që të shpëtojnë e të ngadhënjejnë me lumturi dhe prehje shpirtërore në të dy botët.

## 1. Besimi

Besimi ka ndikim të madh në ruajtjen dhe shërimin nga brengat dhe problemet e ndryshme. Fjalën 'besim' e dëgjojmë shpesh, por të paktë janë ata që kuptojmë esencën, reflektimet dhe rezultatet e tij.

Besimi lë gjurmë të thella në ndjenjat dhe sjelljet e njeriut. Këtu do të paraqesim disa aspekte të tij në ruajtjen dhe mbrojtjen nga pikëllimi.

## 1.1 Kadaja dhe Kaderi (Caktimet paraprake të Allahut të Madhëruar)

Besimi ynë në këto caktime të Allahut të Madhëruar pengon nga pikëllimi i madh. Pejgamberi a.s. ka thënë: "...dhe dije se sikur tërë njerëzit të bëheshin bashkë për të të bërë ndonjë të mirë, nuk do të mundnin po të mos e ketë shkruar Allahu për ty. Po kështu, (edhe) sikur të bëheshin bashkë për të dëmtuar diç, nuk do ia arrinin qëllimit po të mos e ketë shkruar Allahu."

Kur njeriu bindet se gjërat janë të caktuara prej Allahut të Madhëruar, ai nuk brengoset shumë. Si të pikëllohet kur e di se njerëzit nuk mund t'i bëjnë dëm dhe as dobi pa caktimin e Allahut?! Atëherë përse ky ankth? Përse ky pikëllim i madh?

## 1.2. Besimi në Ditën e Llogarisë

Ai që beson në Ditën e Llogarisë, e di se në këtë botë nuk ka të mira të përhershme. Kur besimtari qëllon të humbasë diç nga kjo botë, ai nuk pikëllohet pasi e di se

kjo botë, në raport me ahiretin, nuk vlen asgjë. Ai përkujton fjalën e Pejgamberit a.s.: "Sikur dynjaja të vliente tek Allahu vetëm sa një krah mushkonje, askujt që e mohon Atë nuk do t'i jepte as një gllënjë ujë për të pirë." (Tirmidhiu)

### 1.3. Besimi në emrat dhe cilësitë e Allahut të Madhëruar

Disa mendojnë se besimi në emrat dhe cilësitë e Allahut të Madhëruar është çështje teorike e besimit pa pasur ndonjë ndikim a gjurmë në jetën dhe sjelljet e besimtarit. Si shkak i këtij botëkuptimi të gabuar, ata nuk përfitojnë nga besimi i tyre atë që duhet.

Besimi në këto çështje nuk është vetëm teorik, formal, verbal. Ai ka një ndikim të madh te njeriu. Ai që beson se Allahu është Sundues, beson se Ai ka të drejtë në dhënie dhe privim. Ai që beson se Allahu është i Urtë, e kupton apo jo urtësinë e ndonjë gjëje, beson se ajo ka urtësi.

#### 1.4. Botëkuptimi i besimtarit për sprovat dhe pikëllimet

Botëkuptimi i fatkeqësive te myslimani është i veçantë dhe meriton të shkruhet me ngjyrë ari. Besimtari beson se sprovat mund të vijnë edhe si shenjë e dashurisë së Allahut për njeriun. A nuk ka thënë Pejgamberi a.s.: "Nëse Allahu e do një grup njerëzish, i sprovon." (Imam Ahmedi)

Po kështu beson se sprovimi është në përputhje me nivelin e besimit, duke përkujtuar hadithin: "Njerëzit që më së shumti sprovohen janë pejgamberët, pastaj të mirët pastaj shkallë-shkallë." (Taberaniu)

Besimtari po kështu beson se me t'u sprovuar me fatkeqësi, ai do të shpërblehet. Pejgamberi a.s. ka thënë: "Nuk ndodh të goditet besimtari nga ndonjë lodhje, mundim, brengë, pikëllim, shqetësim, brengë, madje edhe ferra që i hyn në këmbë, e që Allahu të mos ia falë me të mëkatet."

Nëse njeriu e beson këtë, atëherë ai ndihet i qetë me besimin e tij në Allahun e Madhëruar, kurse mbështetja në Të dhe nënshtrimin ndaj Atij vetëm sa i rrënjosen edhe më thellë në zemër.

Po si do të kishte qenë puna që tërë kësaj ai t'ia shtonte edhe durimin? Padyshim se do të shpërblehej shumë. Allahu thotë: "... ndërsa të duruarve u jepet shpërblimi i tyre pa masë!" (Zumer, 10)

Myslimani, çfarëdo që të jetë gjendja e tij, është fitimtar. Muslimi transmeton se Pejgamberi a.s. ka thënë: "Çudi është puna e besimtarit, tërë çështja e tij është në favor për të dhe për askënd tjetër pos tij. Nëse privilegohet me ndonjë të mirë, falënderon, e kjo është mirë për të. Nëse sprovohet me ndonjë fatkeqësi, duron, e kjo është mirë për të."

Pra, botëkuptimi ynë për sprovën është i veçantë.

## 2. Devotshmëria dhe veprat e mira

Devotshmëria dhe vepra e mirë e ruajnë besimtarin nga pikëllimi, brengosja dhe ankthi. Allahu i Madhëruar thotë: "Kush bën vepër të mirë, qoftë mashkull ose femër, e duke qenë besimtar, Ne do t'i japim atij një jetë të mirë (në këtë botë), e (në botën tjetër) do t'u japim shpërblimin më të mirë për veprat e tyre." (Nahl, 97)

Atëherë ç'është jeta e mirë?

A nuk është lumturia dhe qetësia?

Po, për Zotin, tërë ata që kërkojnë lumturinë dhe tërë ata që imagjinojnë jetën e mirë nuk do ta shijojnë as atë dhe as këtë pa punuar vepra të mira. Ka thënë Ibrahim b. Ed'hemi: "Për Zotin, ne jemi duke jetuar një jetë të begatshme që po të dinin mbretërit dhe bijtë e tyre për të, do të na luftonin me shpatë (që ta kenë-përvetësojnë atë)."

Pra, kjo është dhuntia e besimit dhe qetësisë. Është lumturia e vërtetë, të cilën shumë njerëz nuk e kanë gjetur.

## 3. Lutja, madhërimi dhe namazi

Duaja është mbrojtëse, por edhe shëruese, siç tregohet për shembull në këtë hadith: "O Zoti im, kërkoj të më mbrosh nga brenga dhe pikëllimi, dobësia dhe përtacia, koprracia dhe frika, nga mundja prej borxhit (borxhi i madh) dhe nga mposhtja e njerëzve."

Ai që beson në këtë dhe hadithe të tjera të ngjashme, kur goditet me ndonjë sprovë, e lexon atë dhe Allahu i Madhëruar ia largon pikëllimin dhe brengën. Allahu i Madhëruar i drejtohet Muhamedit a.s. që nga fjalët e jobesimtarëve që mërëzitur shumë: "Ne dimë mirë se ti ngushtohesh shpirtërisht për atë që thonë ata. 98. Po ti madhëroje me falënderime Zotin tënd e bëhu prej atyre që luten (përulen duke u falur). 99. Dhe adhuroje Zotin tënd derisa të vijë e vërteta (vdekja)." (Hixhr, 97-99)

Pra, madhërimi i Allahut është çelës i rrugëdaljeve dhe zgjidhjeve të problemeve.

## 4. Shikimi në ata që janë sprovuar edhe më shumë dhe mendimi i gjendjeve edhe më të këqija

Kjo është një praktikë e psikologëve, të cilën para tyre e përdori Pejgamberi a.s. Habbab b. el Eretti kur kishte parë sahabët te vuanin në Mekë, kishte shkuar te Pejgamberi a.s. dhe i kishte thënë: "A nuk po e lut Allahun e Madhëruar të na ndihmojë? A nuk po lutesh për ne? Pejgamberi a.s. iu përgjigj: "Para jush (në kohët e mëhershme) njeriu merrej, i hapej një gropë në tokë ku vendosej dhe me një sharrë të hekurt i ndahej mishi nga ashti, por kjo nuk e largonte prej fesë së tij. Pasha Allahun! Ai do ta plotësojë këtë fe derisa kalorësi (ai që udhëton me ndonjë kafshë) të ecë nga San'aja e deri në



Hadrameut dhe të mos ketë frikë askënd përveç Allahut dhe ujkut për delet e tij. Ju po nguteni pak." (Buhariu)

Kjo është mënyrë psikike e të shëruarit. Nëse takohesh me ndonjë njeri të sprovuar, përkujtoja njerëzit që janë sprovuar edhe më shumë se ai. Nëse dikujt, për shembull, i ka vdekur babai, thuaji se ka familje të tëra që kanë pësuar në aksidente të tilla. Apo thuaji se edhe pse iu ka vdekur babai, ju materialisht qëndroni mirë, ndërsa familja e filanit ka mbetur pas vdekjes së tij shumë keq.

Kur njeriu të goditet me ndonjë fatkeqësi, duhet të marrë mësim nga ata që gjendjen e kanë edhe më keq se ai dhe të thotë: Falënderuar qoftë Allahu! Unë mirë jam.

I varfri shikon atë që është edhe më i varfër.

### **5. Realizmi në këndvështrimin e jetës dhe largimi nga përsosmëria përrallore – idealizmi**

Disa njerëz brengosen ngase mendojnë gabimisht. Të mendosh: "Unë nuk mund të jem i lumtur përderisa njerëzit pranë meje të mos jenë të kënaqur me mua", "Nuk mund të ndihem i qetë përderisa nëpunësit e mi, të gjithë, të mos janë të kënaqur me mua" - është gabim dhe, realisht, diçka e pamundur. Patjetër që do të ketë njerëz që nuk do të ndahen të kënaqur me ty. Sikur njeriu të jetonte me parimin se është e pamundur kënaqja e tërë njerëzve, ai do të jetonte i qetë dhe pa brenga. AbduRrahman es Sa'dijj në librin El vesail el mufide lil hajati's seideh, në koment të hadithit: "Besimtari nuk e urren besimtaren; nëse nuk i pëlqen ndonjë tipar i saj, i pëlqen tjetri", thotë: Ky hadith udhëzon për (mirë)sjellje me gruan, të afërmin, shokun dhe tërë ata me të cilët ke lidhje. Duhet ta bindësh veten se ata patjetër kanë ndonjë të metë që ti e urren, por kur ta gjesh këtë krahasojë me gjërat që ti i ke obligim. Thënë më qartë, krahasojë me gjërat që e mbajnë gjallë lidhjen mes jush duke mos shikuar të metat ngase konsiderata ndaj mirësive mban gjallë shoqërinë dhe lidhjet si dhe arrihet qetësia.

### **6. Opinioni i mirë**

Aspektet pozitive gjithnjë duhet t'iu paraprijnë atyre negative. Njeriu që vetëm ndan mendime të këqija për njerëz, është ai që vuan më shumë. Për shembull: Një njeri kalon pranë një tjetri dhe nuk i jep selam. Ky tjetri mbetet i hutuar dhe i pikëlluar: Përse nuk më përshëndeti? Sigurisht që më urren. Kështu ai fillon të supozojë dhe të jetojë në një gjendje të tillë me ditë të tëra. Sikur t'i ikte këtij mendimi ndoshta do të ndihej i qetë dhe do të mendonte: "Po ai nuk më pa, ndryshe do të më jepte selam", e gjëra të tjera që zhdukin

supozimin dhe pjellën e tij: pikëllimin. Për këtë Allahu i Madhëruar thotë: "O ju që keni besuar, largohuni prej dyshimeve të shumta, meqë disa dyshime janë mëkat..." (Huxhurat, 12)

Ky largim nga supozimet është për të mirën tonë, ndryshe, neve jemi ata që qetësohemi nëse mendojmë mirë, duke mos harruar këtu se mendimi i mirë nënkupton mashtrimin apo tradhtinë e personit që supozon për të. Omeri r.a. ka thënë: "Unë nuk jam tradhtar (mashtroes, njeri që nuk ka një qëndrim), por as tradhtari nuk më mashtron dot."

Myslimani nuk është intrigant dhe as nuk tradhton njerëzit, por as nuk tradhtohet ngase është vigilent.

### **7. Trajtimi i arrogancës së të tjerëve**

Ndodh që njerëzit të shqetësojnë me fjalët e tyre të liga, por ti duhet ta dish se kjo i dëmton ata e jo ty, përveç nëse e preokupon veten me fjalët e tyre, që më pas do të ndëshkohesh me ngushtim shpirtëror. Po braktise këtë, do jetosh i lumtur ngase Pejgamberi a.s. ka thënë: "A e dini kush është i falimentuar (mufli)?" Sahabet thanë: "I falimentuar te ne është ai i cili nuk ka as para e as mall". Tha: "I falimentuar i umetit tim është ai që vjen në Ditën e Gjykimit me namaz, me agjërim, me zekat, por njëkohësisht ai ka sharë atë, ka përgojuar këtë, ka ngrënë pasurinë e atij, ka derdhur gjakun e këtij, ka rrahur tjetrin, atëherë i jepën këtij e atij (atyre që i ka dëmtuar) prej të mirave të tij dhe nëse harxhohen mirësitë e tij para se t'u paguhen borxhet, atëherë do të merren prej mëkateve të tyre dhe do t'i ngarkohen këtij, pastaj edhe ky do të hidhet në zjarr." (Muslimi)

Pra, ai që më merr për gojë, më shan dhe flet keq për mua, ai në të vërtetë më dhuron veprat e tij të mira. Allahu e shpërbleftë! Më duhet të të falënderoj për këtë!

Nëse dikush të thotë diçka të keqe, largohu prej tij dhe lëre ashtu ngase ai do të pikëllohet. A nuk thotë Allahu: "...Thuaju: "Vdisni me atë mllëf tuajin!"..." (Ali Imran, 119)

### **8. Shpresa**

Dera e shpresës është e hapur. Kështu largohet pikëllimi dhe mërzia nga njeriu. Le të përkujtojmë fjalën e Allahut të Madhëruar: "E, pa dyshim se pas vështirësisë është lehtësimi. / Vërtet, pas vështirësisë vjen lehtësimi." (Inshirah, 5-6)

Kjo do të thotë se pas çdo vështirësie vjen lehtësimi, siç na mëson Aahu:«...mirëpo pas vështirësisë Alahu sjell çlirim (begati).» (Talak, 7)

Sa herë që gjërat të vështirësohen, dije se zgjidhja është afër!

# FTESA, THIRRJA PËR TEK ALLAHU DHE I DËRGUARI I TIJ

Si u bë ftesa e njerëzve për tek Allahu dhe i Dërguari i Tij, puna më e dashur, si për Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem), ashtu edhe për sahabët e tij? Sa shumë e dëshironin ata që njerëzit të hynin në rrugën e drejtë, të pranonin fenë e Allahut, duke u përfshirë kështu tërësej në mëshirën e Tij? Çfarë përpjekjesh bënë ata, për t'i bërë njerëzit që të njihnin Allahun, më të Drejtin e të Vërtetin?

## DASHURIA PËR T'U TREGUAR NJERËZVE PËR MË TË DREJTIN

**Si i Dërguari i Allahut digjej si qiriri, vetëm që njerëzit të besonin**

Krenaria e Gjithësisë donte shumë që të gjithë njerëzit të besonin dhe t'i bindeshin Allahut, Atij që është më i Drejti dhe më i Vërteti. Ja se si e përshkruan ajeti kur'anor këtë dëshirë të tyre. "Duket sikur do të hash veten nga mërzia pse njerëzit nuk po besojnë. Po të donim, ne u zbritnim atyre një mrekulli të atillë prej qiellit, që duan s'duan do të binden." (Shu'ara, 26/3-4) Vetëm se, Allahu, me këtë ajet, tha: "Disa njerëz janë fatkëqinj, e disa të tjerë janë të lumtur." (Hud, 11/105). Në përmasën e kaderit, disa janë të përshtatshëm për të besuar, e disa të tjerë janë shumë larg prej tij, ndaj edhe janë fatkëqij.<sup>1</sup>

**Thirrja që i bëri Resulullahu fisit të tij kur vdiq xhaxhai i Tij, Ebu Talibi**

Kur Ebu Talibi u sëmur, një grup nga kurejshët, i përbërë nga Utbe bin Rebia, Shejbe bin Rabia, Ebu Xhehl bin Hishami, Umeje bin Halefi dhe Ebu Sufjan bin Harbi, erdhën pranë dhe i folën Profetit tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) duke i thënë: "Nipi juaj po i shan zotat tanë, madje nuk ka lënë gjë pa u bërë dhe pa thënë për ta. Sikur ta qortoni dhe

ai të heqë dorë nga kjo punë. O Ebu Talibi! Ti je i yni. Tani ti je duke vdekur, dhe ne jemi shumë të shqetësuar për ty. Ti e di shumë mirë problemin që ne kemi me nipin tënd. Thirre dhe kërkoi atij që të të japë fjalën. Të mos ngatërrohet më me ne, e as ne nuk do të ngatërrohemi me të. Të mos merret me fenë tonë, e as ne nuk do të ngatërrohemi me fenë e tij." Pasi i dëgjoi, Ebu Talibi dërgoi fjalë që t'a thërrisnin nipin e tij, Profetin tonë (sal'lallahu alejhi ue sel'lem). I Dërguari i Allahut erdhi menjëherë. Në mes të të gjithë atyre që ishin të pranishëm dhe xhaxhait të Tij kishte vend sa për t'u ulur veç një njeri i vetëm. Që i Dërguari i Allahut të mos ulej pranë Ebu Talibit, Ebu Xhehli e zuri menjëherë atë vend, duke e penguar kështu Profetin e nderuar (alejhis'selam) të ulej pranë xhaxhait të vet. Sepse, nëse Resulullahu do të ulej në atë vend, xhaxhait do t'i vinte keq për nipin dhe sakaq mund të shpallte edhe ai besimin në Islam. Edhe i Dërguari i Allahut, kur pa se nuk kishte ndopak vend që Ai të mund të ulej diku pranë xhaxhait, u ul pranë derës. Ebu Talibi i tha: "Nipi im! Ç'është ky shqetësim i fisit për ty? Më thonë se nuk ke lënë fjalë të keqe pa thënë për zotat tanë."

Sipas një transmetimi tjetër, Ebu Talibi i pati thënë këto fjalë të Dërguarit të Allahut, duke na treguar se ajo bisedë ka qenë më prekëse: "Shiko, o biri i tim vëllai! Që kurse të kam njohur ti kurrë nuk e ke kursyer respektin ndaj meje. Por, këta njerëz që kanë ardhur këtu, më thonë se ti shkon në Qabe dhe thua fjalë të rënda për të gjithë. Si thua, sikur të heqësh dorë nga kjo punë, hë si thua, nipi im!" Krenaria e Gjithësisë i pati ngritur sytë drejt qiellit dhe i pati thënë xhaxhait:

"Ju betohem, se ashtu siç ju nuk keni fuqi as për të kapur qoftë edhe një rreze të vetme të këtij dielli, as unë nuk kam fuqi, pasi nuk është në dorën time, që të heq dorë nga kjo detyrë e profetësisë që Zoti më ka ngarkuar mbi supe."<sup>2</sup>

Ndërsa, sipas një transmetimi tjetër Ebu Talibi i ka thënë:

2. Hejthemi, *Mexhmen'z-Zeuaid* 6/8 (6809).

1. Hejthemi, *Mexhmen'z-Zeuaid* 7/196 (11243).



"Nipi im! Diç më thanë këta njerëz që kanë ardhur tek unë. Të lutem, të të vijë pak keq edhe për mua, edhe për veten! Mos më ngarko mua me një barrë, për të cilën nuk kemi fuqi që ta përballojmë! Hiq dorë nga të folurit e fjalëve që nuk u pëlqejnë njerëzve të popullit tonë!"

Aty, kur dëgjoi këto fjalë nga goja e xhaxhait të Tij, të Dërguarin e Allahut (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) seç e kaploi një ndjesi se ai po i thosh se nuk do të ishte më i gatshëm për ta ndihmuar, duke e lënë kështu pa kurrfarë mbështetjeje, ndaj iu përgjigj me këto fjalë: "O Xhaxhai im! Sikur të ma vënë diellin në të djathtën dhe hënën të ma vënë në të majtën, unë nuk heq kurrë dorë nga misioni im. Deri në atë ditë, kur ose Allahu do të shpallë ngadhënjimin e fesë së Tij, ose unë do të vdes në këtë rrugë." Mandej Krenarisë së Njerëzimit iu mbushën sytë me lot dhe filloi të qante.<sup>3</sup>

Në atë kohë, paria e Kurejshëve që ishte e pranishme aty filluan të thoshin gjithfarë fjalësh kundër Profetit të Gjithësisë. Disa prej tyre thanë: "Ore! Nëse ke nevojë për ndonjë gjë, na thuaj, të mbledhim pasuri për ty sa të duash; të bëhesh ti më i pasuri i mbarë Kurejshëve! Nëse do që të kesh shumë gra, eja dhe zgjidh kë të duash prej grave, eja, po të duash, të të martojmë me dhjetë prej tyre njëkohësisht!"<sup>4</sup>

"Shiko, kushëriri im! Në mesin e familjes sonë ti je një njeri i zakonshëm; por në sytë e mi ti qëndron mbi të gjithë ne. Por, me sa po më shohin sytë, ti po përpiqesh që të futësh në mes të njerëzve tanë një ngatërsesë të atillë, që deri më sot askush nuk ka guxuar që ta bëjë. Nëse, me këto që thua, qëllim ke që të bëhesh i pasur, populli është i gatshëm që të bëjë ç'të jetë e mundur për ty, e mund të bëhesh ti më i pasuri ndër të gjithë ne. Nëse është nderi ai që kërkon, na thuaj e ne do të të ofrojmë ç'pozicion që të duash, madje jemi të gatshëm të të ofrojmë edhe atë më të lartin. Edhe nëse të kanë goditur shpirtrat e këqinj, e prandaj i thua të gjitha këto dhe e ke shumë të vështirë që të shpëtosh prej tyre, ne jemi gati që ta sakrifikojmë gjithçka, për të të kuruar, që vetëm ti të shpëtosh. Por jo, nëse dëshira e qëllimi yt është të bëhesh mbret, atëherë ne jemi gati që të të bëjmë edhe mbret." – i pati thënë Utbe bin Rebia.

Ndërkaq, i Dërguari i Allahut (paqja e Zotit qoftë mbi të) nuk iu përgjigj fjalëve të tyre, por u këndoi nga sureja "Fussilet" deri në ajetin e tridhjeteshtatë të saj.<sup>5</sup>

Resulullahu u kthye sërish nga xhaxhai i Tij dhe i tha: "Unë ata po i ftoj në një fjalë, që nëse ata e thonë atë me sinqeritet, duke e pranuar, kjo do t'i bëjë ata që të gjithë arabët dhe të gjithë axhemët (të huajt) t'i paguajnë xhizje.

Grupi i kurejshëve, e dinin se me atë fjalë Ai kishte parasysh fjalën e dëshmisë së njëjesisë së Zotit, ndaj zunë menjëherë të ulërinin: "Ç'na qenkësh! Vetëm një fjalë e vetme! Të mos guxosh të na e zësh më në gojë

atë fjalë! Për hir të babait tënd, ne bashkohemi rreth çdo fjale tjetër që ti mund të na kërkosh ta pranojmë, por për këtë jo." Përplasnin duart të gjithë dhe kundërshtonin. Ebu Talibi, i cili i pati dëgjuar të gjitha sa u thanë, u drejtua edhe njëherë nga i nipi dhe e pyeti: "E ç'fjalë është kjo, o nipi im?" Resulullahu (sal'lallahu alejhi ue sel'lem) iu përgjigj duke thënë: "La ilahe il'lallah". Me të dëgjuar atë fjalë, grupi i kurejshëve, të mbërthyer nga një shqetësim çmeritës, si të zënë në panik, u çuan menjëherë vendit. U çuan dhe thanë: "I është ngulitur në mendje, do që t'i shndërroj tërë ata zota në një të vetëm! Kjo është për t'u habitur, është e çuditshme!" (Sad, 38/5)<sup>6</sup> Kur e kuptuan se nuk mund të arrinin asgjë prej Profetit tonë të nderuar, u larguan të gjithë. Ebu Talibi i foli nipit të tij: "Nipi im! Më beso, ti nuk u the atyre asgjë që e kalon cakun!" Profeti ynë, duke menduar se nëse do t'i fliste xhaxhait të tij që e donte aq shumë, në ato çaste, ai do të pranonte e do të besonte, ndaj i tha: "Xhaxha, atëherë thuaje edhe ti atë fjalë, në mënyrë që, në ditën e kiametit, unë të mund të hyj si ndërmjetës për ty." Ebu Talibi e kuptoi mjaft mirë se me sa përzemërsi po ia thoshte këto fjalë nipi i tij i drejtë, dhe iu përgjigj:

"Nipi im, sikur të mos kisha frikë se ata mund të të bëjnë keq ty dhe njerëzve pranë teje dhe të mos druhesha prej fjalëve që do të thoshin kurejshët, se "e pranoi atë fjalë ngase pati frikë nga vdekja, do ta kisha thënë atë fjalë, qoftë edhe vetëm për të të gëzuar ty."<sup>7</sup>

Në një transmetim tjetër,<sup>8</sup> Profeti ynë i dashur është afruar pranë xhaxhait të Tij që ishte në çastet e fundit në këtë jetë. Aty ka qenë i pranishëm edhe Ebu Xhehli. Resulullahu i ka thënë: "Xhaxha, eja, thuaje fjalën e dëshmisë, në mënyrë që unë të mund të të mbroj përpara Zotit."

Ebu Xhehli dhe idhujtarët e tjerë, ushtronin vazhdimisht trysni mbi Ebu Talibin, duke i thënë: "Si, po heq dorë nga feja jote?" Vetëm kur u tha: "Jo, unë po vdes në fenë e Abdulmutalibit", ata u qetësuan dhe e lanë të qetë. I Dërguari i Zotit, me zemrën të plagosur, nuk tha gjë tjetër, pos fjalëve: "Gjersa të më ndalohet, do të vazhdoj t'i lutem Zotit, që Ai të të falë." Më vonë, u zbritën ajetet, "Nuk i takon të Dërguarit dhe besimtarëve që të kërkojnë falje për idhujtarët, qofshin këta edhe të afërmit e tyre, pasi u është bërë e qartë se ata janë banorë të Xhehenemit." (Teube, 9/113) dhe "Vërtet, ti (Muhamed) nuk mund të udhëzosh kë të duash, por është Allahu Ai që udhëzon kë të dëshirojë. Ai i njeh më mirë ata që janë të udhëzuar." (Kasas, 28/56)<sup>9</sup>

**Shkëputur nga libri "Jeta e Sahabëve 1"  
M. Jusuf Kandeheui  
Botim i KMSH**

6. Ibni Kethir, *el-Bidaje* 3/123.

7. Ibni Hisham, *Sire* 2/265.

8. Buhari, *Sahib* 3/1409 (3671).

9. Buhari, *Sahib* 4/1717 (4398).

3. Ibni Kethir, *el-Bidaje* 3/42.

4. Ibni Kethir, *el-Bidaje* 3/62.

5. Ibni Kethir, *el-Bidaje* 3/62.



# *Largësia nga libri anormalitet i normalizuar*

Batica teknologjike që ka mbërritur tashmë në çdo shtëpi, në çdo dorë njeriu, është kthyer në një sipërmarrje të vështirë për t'u sfiduar. Shumë syresh janë dorëzuar që në valën e parë të goditjes, madje mezi e kanë pritur këtë goditje. Të tjerë vazhdojnë të kapitulojnë ditë pas dite, duke u kthyer në konsumatorë të regjur të energjisë që çliron kjo baticë, me shpresën se do të zëvendësojnë energjinë e shteruar për jetë. Vetëm një pakicë syresh, të cilët janë zgjedhur për të qenë të tillë, vazhdojnë të rezistojnë mes valëve të kësaj baticë, duke u munduar të çojnë drejt atrofizimit efektet e energjisë së saj, në hapësirën e tyre ekzistenciale më së pari.

Njeriu është një qenie që lehtësisht anon në drejtim të asaj që është më e lehtë për t'u kryer, drejt asaj që është më në përputhje me dëshirat lëndore dhe, si rrjedhojë, nuk e ka shumë për zemër t'i hyjë një sipërmarrje që shkon në kah të përkundërt me atë që dëshiron më së shumti egoizmi vetjak. Por, sigurisht që jo të gjithë do të jenë të inkorporuar në këtë kategori. Ata që janë zgjedhur për të qenë në antagonizëm të vazhdueshëm me energjinë baticore të teknologjisë, që për hir të së vërtetës vazhdon të fitojë terren, nuk do të epen përderisa do të qëndrojnë të paepur në kufijtë e parimeve paraqe.

Për çdo njësi terreni që bie në duart e baticës teknologjike, zvogëlohet sipërfaqja ku qëndrojnë ata të cilët, afërsinë me librin e kanë lidhje të shenjtë, sepse dituria është e tillë. E megjithatë, ajo çfarë mbetet në fund të fundit e rëndësishme, nuk është sasia, por cilësia e atyre që do të arrijnë të rezistojnë përballë kësaj baticë. Natyrisht që kërkohet punë,

lodhje, djersë, sakrificë, orë të pakta gjumë, thellim në të kuptuar, biseda e diskutime me më të diturit apo me më pak të diturit, por gjithsesi të dashuruar me librin.

Nevoja për të qëndruar i lidhur me librin është bazike dhe jo plotësuese, pasi të diturit është thelbi që të çon drejt udhëve të së mirës dhe mirësisë, drejt vlerave dhe virtyteve, drejt njohjes më të thellë të botës dhe njeriut si qenie në botë, për t'i dhënë kësaj shpjegim asaj gjëje që për një shumicë syresh është lënë jashtë vëmendjes dhe sferës së interesit. Dhe kjo gjë, e cila është lënë jashtë vëmendjes, sigurisht që, në mes të zallamahisë dhe poteres së shkaktuar nga batica teknologjike, do të jetojë e pahetuar, do të jetë gjithmonë përballë qenies njerëzore, por kjo qenie nuk do ta shikojë, nuk do ta dëgjojë dhe as që do ta kuptojë, përderisa ka sy me të cilët nuk sheh, veshë me të cilët nuk dëgjon dhe zemër me të cilën nuk kupton.

Kjo baticë, duke mbërritur në dorën e çdo njeriu, po mbisundon dhe po imponohet edhe tek ajo pjesë njerëzish, të cilët për shkak të mjedisit ku gjenden, me apo pa dëshirën e tyre, kanë kontakt me librin, edhe pse në shumicën e rasteve këta libra janë tekste shkollore të kurrikulave që zhvillohen në shkollë apo më tej në universitet. Të etur për t'u zhytur në botën e teknologjisë, të etur për të eksploruar apo për të shijuar realitetin virtual, nxënësi apo studenti i së sotmes i bën një shërbim të shquar baticës teknologjike, i jep shansin të zgjerohet më tej në dëm të librit, në dëm të vetë atij si qenie njerëzore, por meqenëse ende nuk i ka dhënë kuptim pakuptimësisë së ekzistencës, vazhdon të kontribuojë si ushtar i zellshëm dhe i verbër në zaptimin e hapësirës së mendimit nga teknologjia.

Kësisoj, klasat dhe auditorët mund të gëlojnë nga

prezenca e shumëlojshmërisë së smartphone-ve, gëlojnë nga këngët apo klipet më trendi, nga fotot e pafund në mjediset shkollore, ku na dëshmojnë se sa shumë e duan dijen. Mbushja e kohës së nxënësit apo studentit me argëtim, nuk i lë më kohë të angazhohet me librin dhe këtu nuk e kemi fjalën vetëm për tekstin shkollor, por edhe për libra të tjerë jashtëshkollorë, të cilët një brez në formim e sipër e ka për detyrë t'i lexojë dhe të kridhet në thellësitë e tyre.

Të nxitësh, të vësh në lëvizje dëshirën për të lexuar, të kultivosh vullnetin për të dashuruar librin, është një detyrë e shenjtë, që duhet realizuar në vazhdimësi që nga vegjëlia. Sot, mundësitë infrastrukturore janë, por batica teknologjike është më joshëse dhe si rrjedhojë ata që duhet të jenë në vijën e parë të frontit të leximit, kanë dezertuar masivisht, duke e konsideruar librin si gjënë më pa vlerë. Ata, në vend që të ndezin zjarrin e shpirtit, shkojnë e ndezin zjarrin për t'u ngrohur nga ethet e lagështisë baticore.

Ky zhvlerësim i librit nuk është përgjegjësi vetëm e nxënësve apo studentëve, pasi që duhen detektuar ata që kanë dëshirë për

të lexuar dhe duhen ushqyer me libra që të ndezin zjarrin e shpirtit për të jetuar.

Nuk mund të konceptohet që një nxënës, i cili kryen arsimin parauniversitar, të mos ketë lexuar autorë si Lev Tolstoi (Lufta dhe Paqja), Nikollaj Gogol (Frymë të vdekura), Fjodor Dostojevski (Vëllezërit Karamazov), Franz Kafka (Procesi, Metamorfoza), Xhejms Xhojs (Portreti i artistit në rini), Shekspir (Hamleti, Makbethi), Gëte (Fausti), Dante (Komedia Hyjnore), Rëne Guenon (Kriza e botës moderne), Osvald Spengler (Njeriu dhe teknika) e shumë e shumë të tjerë shkrimtarë mbarëbotërorë, por më së shumti mbarënjëzorë.

Pa lexuar dhe kuptuar kryeveprat e mendimit botëror qysh në adoleshencë, do të jetë e vështirë të formojmë personalitete të qëndrueshëm dhe me vizion, të papërkulshëm para ndërprerjes së "koromanes" dhe shpirtra të etur për frymën e jetës.

Prandaj na lind si detyrë të përpiqemi të mbjellim farat e dashurisë për librin, për të ngushtuar largësinë e nxënësit dhe studentit nga zjarri i jetës, në mënyrë që ky anormalitet të mos konsiderohet si pjesë e standardit normal të jetës.







# Lutja dhe vetëdija e ihsanit të PROFETI A.S

Në hadithin e njohur me emrin "Hadithi i Xhibrilit a.s.", Profeti ynë, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të, pasi ka shprehur shtyllat e besimit dhe të Islamit, pyetet në lidhje me një term të quajtur ihsan, që përkthyer nga arabishtja do të thotë mirësi. Ç'është ihsani? – e pyet engjëlli, i dërguar enkas për t'i bërë Profetit a.s. disa pyetje në publik, në mënyrë që njerëzit të mësonin më tepër për sistemin fetar të cilin besonin. Dhe Muhamedi a.s. i jep këtë përgjigje: "Ta adhurosh Zotin/të jetosh me vetëdijen se je një rob i Zotit, sikurse e sheh Atë. Sepse megjithëse ti nuk e sheh, Ai të sheh ty."

Në fakt, kjo fjalë profetike po tregonte etapat prej të cilave kalon gjithkush që beson Fenë Islame. Në krye, në zemrën e njeriut ndizet shkëndija e besimit. Në momentin

që ky besim tashmë ka zënë vend në zemrën e tij, kalohet në etapën e dytë, ku njeriu nis të jetojë ashtu siç udhëzon besimi i tij. Kështu nis të kompletojë mozaikun e adhurimeve me në krye fjalën e dëshmisë dhe namazin, e pastaj me adhurimet e tjera si agjërimi, lëmosha, haxhi, etj. Një besimtar që jeton duke plotësuar të gjitha këto dimensione të besimit, dalëngadalë arrin në një etapë të tretë, pra ihsanin, i cili është edhe një qëllim i lartë për çdo njeri.

Ihsani është një gradë e lartë dhe, logjikisht, çdo besimtar duhet ta ketë pasuruar jetën e tij me këtë dimension të besimit. Por ja që në fakt, nuk është pikërisht kështu. Arritja e ihsan-it mbetet një sfidë për çdo besimtar.

Si në çdo çështje tjetër, edhe në vetëdijen e të qenit

krijesë e Allahut të Madhëruar, shembulli më i lartë është Profeti ynë a.s. Me jetën e tij, ai na ka orientuar edhe në çështjen e ihsanit. Në këtë aspekt, lutja në jetën e të Dërguarit a.s. është një dinamikë e rëndësishme për të arritur vetëdijen, që Zoti vazhdimisht na sheh, pavarësisht se ne nuk e shohim dot Atë. Një person, i cili kur ngihet në mëngjes e nis ditën me falënderim, kur ha mëngjesin e nis me emrin e Allahut, kur del nga shtëpia i lutet Allahut që dita t'i kalojë mirë dhe që çdo gjë të shkojë sipas kënaqësisë së Tij, që çdo punë e nis me Bismil'lahir Rrahmanir Rrahim, do të jetë gjithnjë i vetëdijshëm se Zoti atë e vështron. Ky person edhe kur të gabojë, do të jetë i vetëdijshëm që ka gabuar përpara Zotit dhe do të pendohet me sineritet.

Por një njeri, në jetën e të cilit nuk gjendet lutja, është më e vështirë që të jetë vigjilent ndaj veprave të tij. Shpeshherë ai harron që gjendet përpara audiencës hyjnore dhe, si rezultat, shumë vepra nuk korrespondojnë me kënaqësinë e Allahut të Madhëruar.

Jo më kot Allahu shprehet kështu në suren Furkan: "Zoti im nuk do t'ju përfillo, sikur të mos ishte lutja juaj" (Furkan 25/77), e na sugjeron: "Lutmoni Mua, se do t'ju përgjigjem!" (Gafir, 40/60). Sepse lutja formon një relacion të fortë mes robit e Zotit.

Çdo veprim i Profetit a.s. ishte i mbështetur në një dua. Ai nuk dilte në udhë pa iu mbështetur të Plotfuqishmit. Në librat e hadithit vërejmë lutjet e tij në namaz, para gjumit, kur hynte në shtrat, kur ngrihej për tehexhud, kur zgjohej në mëngjes, kur bëhej darkë, kur nis ushqimin e kur e përfundon atë, madje edhe kur hyn e del nga banja për të kryer nevojat e tij personale. Të përmendim disa shembuj rreth lutjeve të tij kuptimplota:

Sapo zgjohej në mëngjes thoshte: "Zoti im, u gdhiva duke pohuar se: Ti je Allahu, nuk ka zot tjetër veç Teje dhe se Muhamedi është robi Yt e Profeti Yt dhe për këtë të mbaj Ty dëshmitar dhe mbaj dëshmitarë të gjithë banorët e gjithësisë, gjithë engjëjt e gjithë krijesat".

Kur bëhej darkë: "Zoti im! U ngrysa duke dëshmuar e duke mbajtur dëshmitarë të gjithë ata që mbajnë kupën e qiejve, engjëjt e gjithë krijesat, se nuk ka zot tjetër veç teje, se nuk ke shok e as ortak dhe se

Muhamedi është robi dhe i Dërguari Yt".

Pas ushqimit: "Falënderimi i takon Allahut, që na shuajti urinë dhe etjen, dhe na bëri besimtarë".

Kur vishte rrobat: "Falënderimi i takon Allahut, që më veshi këtë rrobë dhe ma dhuroi, pa përpjekjen dhe fuqinë time".

Kur hynte në xhami: "Me emër të Allahut, paqja e bekimi qofshin mbi të Dërguarin e Tij a.s. O Zoti im! M'i fal mëkatet dhe m'i hap dyert e mëshirës".

Kur dilte nga xhamia: "Me emër të Allahut, paqja e bekimi qofshin mbi të Dërguarin e Tij a.s. O Zoti im! Të kërkoj nga mirësia Jote! Zoti im! Më mbro nga shejtani i mallkuar!"

Kur ngrihej nga një kuvend: "Zoti im! Ti je larg çdo të mete. Falënderimet dhe lëvdatat janë vetëm për Ty. Dëshmoj se nuk ka zot tjetër veç Teje. Kërkoj faljen Tënde dhe tek Ti pendohem".

Pasi pinte ujë: "Falënderimi i takon Allahut, që me mëshirën e Tij, na shuajti etjen me ujë të freskët e të ëmbël dhe që nuk e bëri atë të kripur e të papijshëm".

Kur shihej në pasqyrë: "Falënderimi i takon Allahut. Zoti im! Ma zbukuro moralin, ashtu siç më ke krijuar të bukur".

Kur hipte në një mjet transporti: "Larg çdo të mete është Allahu, që na ka dhënë në shërbim këtë mjet, sepse ne vetë (pa ndihmën dhe krijimin e Tij) nuk mund t'ia arrinim dot kësaj. Pa dyshim që kthimi ynë është tek Allahu".


Kur hynte në shtëpi: "Zoti im! Të kërkoj mirësi në hyrjen dhe daljen time. Me emrin e Allahut hymë, me emrin e Tij dolëm dhe tek Allahu mbështetemi".

Kur dilte nga shtëpia: "Me emrin e Allahut. Mbështetem tek Allahu. Çdo lloj ndihme vjen vetëm me fuqinë e Allahut të Madhërishtëm".

Përpara se të flinte: "Vdes dhe ngjallet (fle dhe zgjohem), duke përmendur emrin Tënd".

Shembujt që përmendëm deri këtu janë disa nga fragmentet e një jete e përkushtuar Allahut, Krijuesit të gjithësisë. Ai është shembulli më i madh për ne si në të gjitha këndvështrimet e jetës ndër të cilat është edhe adhurimi.

Kush e kalon ditën e tij duke shprehur vazhdimisht këto lutje, patjetër që do të ecë drejt vetëdijes së përsosur, ihsanit. Zot na bëj prej atyre, që ndjekin udhën e ndritur të Profetit a.s.!



# Lindja e Profetit

Studimi e kërkesa, si dihet, po vazhdojnë pa prerë për të gjetur djepin e parë të përparimit njerëzor. Me fjalë të tjera: vallë ku filloi ky përparim, mbresat e të cilit arrijnë deri te qindvjetëshi ynë. Ky studim e kjo kërkesë, për një kohë të gjatë, pohonte se Egjypti ishte djepi i parë i përparimit për 6000 vjet me radhë dhe se më përpara kësaj kohe këthehemi në kohëra prehistorike që zbulimi i tyre, simbas methodës shkencore të vërtetë, është i vështirë. Faktet historike të historisë të afërme na vërtetojnë se dijetarët e Antikitit kanë gërmuar e kërkuar dhe po vazhdojnë të gërmojnë e të kërkojnë në Irak (Mesopotamie) dhe në Syrie duke shpresuar të kuptojnë e të gjejnë rrënjët e përparimit Assyerin dhe Finicien dhe duke dashur të vërtetojnë epokën te e cila zënë fill a më mirë këthehen këto dy përparime: a është një epokë që parakalon epokën e përparimit Egjyptian Faraonik apo është pasardhës i këtij përparimi i influencuar prej tij? Çdo gjë që ka për të nxjerrë në shesh kërkimi i dijetarëve t'Antikitit në këtë anë të historisë, nuk do të ndërrojë asgjë prej së vërtetës mbasi kërkimi n'Antikitit e Çinës dhe të Lindjes së Largët nuk ka zbuluar ende diçka që t'i kundërshtoj. Kjo e vërtetë është gjithnjë se djepi i përparimit të njeriut të parë a të lashtë, qoftë Egjypti, qoftë Fenicia ose Assyria, ishte i puqun me brigjet e detit Mesdhetar dhe ato të Detit të Kuqi, shto edhe se Egjypti ishte qendra më e fortë prej së cilës rrodhi rryma e përparimit të parë, një herë për në Greqi, pastaj edhe për në Romë. Gjithashtu duhet të përmendim se përparimi

botëror në këtë qindvjetësh, në të cilin jetojmë, vazhdon të ketë lidhje të ngushtë e marrëdhënie të fortë me atë përparim të parë dhe se çdo gjë që ka të bëjë me historinë e përparimit n'ato vende dhe që e ka zbuluar kërkimi në Lindjen e Largët nuk pat lënë ndonjë vragë të dukshme në ndonjë kohë n'orientimin e përparimevet: Faraonik, Assyrian dhe Grek. Po, nuk e ndryshoi drejtimin e përparimevet në fjalë as edhe evolusionin e tyre për deri sa këto qenë ndërlidhur e patën ardhur në marrëdhënie me përparimin islamik, i cili ia mbresë ndër ta; këta u-influencuanë aqë shumë saqë, në qytetërimin njerëzor qëi shtrohet sot njerëzija, një pjesë e madhe e këtij qytetërimi, ndofta më e madhja dhe më themelorja, meriton të quhet islamike.

Dihet fare mirë prej gjithëkujt se lulëzimi i qytetërimet të sipërpërmendura, pat arritur shkallën më të mrekulluar n'Egjypt, Assyrie dhe Greqi aqë sa edhe sot është objekt i habitës dhe i admirimit të botës. Lulëzim ky në diturie (shkencë), industrie, bujqësi, tregëti si edhe n'artin luftarak. Porse, rrënja a gurra prej të cilës këto qytetërimet burojshin dhe fuqizoheshin ishte në çdo periudhë apo gurrë këjo që vërtitej nga një anë ndërmjet trinitetit të vjetër egjyptian, i cili përfytyrohej n'Osiris, Isis dhe Horus që i bënte shenjë unjisimit të jetës në rrënimin dhe përtëritjen e saj, në immortalitetin e pakëputur që kapërcente prej prindërve të bijtë dhe nga ana tjetër ndërmjet t'idhujtarisë greke që përfytyrohej në të Vërtetë (El Hakk), në të mirën (el hajr) dhe në



të bukurën (el xhemal), përfytyrim ky i marrur prej shfaqëjeve të qënmërisë që i shtrohen ndjenjës. Përsëri ndryshoi pastaj aq shumë shkallëvet (Dunëja el meratibi) në qindvjetorin e ndryshëm të dekadencës dhe t'errësirës. Porse, rrënja apo gurra mbeti gjithnjë themeli i këtyre përparimevet që trajtuan ecjen e botës, rrënjë këjo e cila ka lënë edhe një mbresë të madhe në përparimin e qindvjetësishit në të cilin jetojmë – sado që ky i sotëshmi përpiket t'i shpëtojë duke e përballur – i cili po tërhiqet gradualisht drejt saj. Kush e di ndofta, do ta inkorporojë mbrenda suazës së sajë në të ardhëshmen e afërt ose të largët!

Në këtë medium, në të cilin përparimet u mbështetën mbi origjinën fetare mijëra vitëra me radhë, u lindën të dërguarit a prijësat e religjioneve të njohura: n'Egjyptë u lind e u rrit Moiseu, i cili përmbysi kryeneçësinë e Faraonit që predikonte me moton "ene rabbuqumulaëla"; në Palestinë Isai. Si i pari ashtu edhe i dyti pa dyshuar predikuanë Unitetin Hyjnor, megjithëse njerëzit në kohët e errëta të dekadencës e lanë këtë Unitet duke përqaftuar dikush një besim dualistik, dikush një besim trinie dhe disa të tjerë një besim pluraliteti.

Ky është një fakt më se i vërtetë. Por, për ta këthyer njerëzinë përsëri drejt Unitetit Origjinal, u pa nevojë të delte një lajmëtar tjetër. Ky ishte Profiti Muhamed (a.s.), i paralajmëruar prej librave të shenjtë e prej devinatorëve të mëparshëm. U lind n'Arabi, e cila rrethohej n'atë kohë prej dy fuqish të ndryshme, të kundërshtuara njëra me tjetrën. Fuqija e Kristjanismës dhe e Magismës, fuqija e Perëndimit dhe e Lindjes, mbrenda qarkut të të cilave përfshiheshin edhe shtete satelite të vegjëla, që i ngjiteshin ose i shtroheshin përshtypjes së tyre. Ishin këto dy fuqira që e rrethojshin Siujdhesën Arabike në vitet e para të të gjashtit qindvjetor. Megjithëse çdo njëra prej këtyre kishte lakmira të mbëdha kolinizimi dhe shtrirjeje, me gjithë mundimin që harxhojshin burra e religjionevet për të përhapur Ftesën në Besimin që ata besojshin, Siujdhesa mbeti e paprekur sikur t'ishte një Oazie e fortifikuar dhe e sigurtë prej okupimeve dhe kështu do të mbetet gjithnjë e sigurtë dhe larg prej Ftesës Fetare të çdo religjioni që të jetë përveç Islamit. Këjo shfaqëje a ky fenomen duket krejt i habitshëm në Historie. Është kështu me të vërtë sikur të mos gjendej diçka që e shpjegon, e cila është pozita që zë Arabia si dhe natyra (fizike) e saj, duke i shtuar këtyre të dyjavet dhe mbresën që këto lënë në jetën e popullatës së sajë, në moralin e tyre, në animet dhe në prirjet e tyre. Në këtë vend lindi Muhamedi, Ditëlindjen e të cilit e festojnë të tërë besnikët anë e kand botës islame sikur vepruamë edhe ne këtu në Shqipërinë tonë të dashur nëpër faltoret e ndryshme.

Pak më lart përmendëm që në kohën kur lindi Profiti më të forta shfaqëje të qytetërimit botëror

qarkullojshin dy pellgjet e deteve; Mesdhetar dhe të Kuq. Është gjithashtu për të përmendur se Kristjanizmi dhe Jahudismi, n'atë epokë, kishin zënë vend për bri njëra tjetrës në mënyrë që edhe po qe se nuk kishin ndonjë armiqësi të dukëshme në mes të tyre, nuk kishin dashuri të dukëshme ndërmjet njëra-tjetrës. Judenjt përmendshin kryengritjen e Isajt kundra fesë së tyre si edhe të dalurit e tij prej saj, aqë sa punojshin në mënyrë sekrete çdo gjë që të mundeshin për të mprapsur dallgën e Krishterimit që i kishte nxjerrë jashtë tokës së premtuar. Judenjt, gjithashtu, kishin arritur të vendosin edhe n'Arabie disa kolonira, një pjesë e tyre kishte zënë vend në Jemen e një pjesë tjetër në Jethrib. Nga ana tjetër edhe Magismi Persjan qëndronte përballë fuqivet të Krishtere për që këto të mos e kalojshin Euphratin për t'u shtrirë në Perësie; ky veprim forcohej prej fuqisë shpirtërore të tërë sistemeve dhe institucionevet idhujtare kudo që të gjëndeshin. Porse, rënja e Romës dhe zhdukja e pushtetit të sajë, mbassi u çua kryeqyteti në Bizant dhe tëra ato shfaqëje zbërthimi që ndoqën këtë ndryshim, shkakëtuan, provokuan dhe kompromentuan një situatë tjetër, e cila lejoi të shtohen përsëri partirat e krishtere, duke u zënë e vrarë njëra me tjetrën, duke u gremisur prej gradëve më të larta të besimit, dhe, së fundi, duke u kufizuar mbrendë prangavet të verbalismës si p.sh. të bieseduarit mbi sasinë e shenjtërisë së Merjemes dhe të parësisë së sajë mbi Birin ose mbi parësin e tij mbi të etj, që paralajmëronin se kudo që gjinden shkaktojnë rrokullisjen e çdo gjëje prej të cilës prej të cilë shkaktohen edhe i këthejnë njerëzit të bëhen të furishëm e armiq ndaj njëri tjetrit. Ndoth kështu sepse lehet më një anë thelbi duke u preferuar celfat. Pastaj duke i stivosur celfat mbi thelbin shkaktohet të mëshehurit e qëllimit dhe të së vërtetës. Kjo i bën të pamundur njerëzit për t'i çarë ato perde celfash dhe për t'arrirë qëllimin e duhur. Kështu ndodhte në botën që qarkullonte Arabinë kur lindi Muhamedi. Por, ngjarja më apokaliptike se të gjitha të tjerat ishte ajo e përhapjes s'idhujtarisë si edhe adhurimi yjvet në Siujdhesën Arabike, kaq sa për periudha të gjata njerëzit e kishin ngulur bazën e jetës së tyre mbi këtë idhujtari t'errët.

Vendi i lindjes së H. Muhamedit është Mekka. Qysh prej shumë kohësh më parë flitej përmbi një Profit që do të dukej midis arabëve, gjë kjo që në qarqet e ndryshme Mekkase po provokonte disa shqetësime. Ebu Sufjani një ditë pa qortuar Umejje ibn Ebi Saltin sepse ky i fundit përsëriste ato që përmendshin murgjët rreth kësaj çështje. Ndofta kishte të drejtë që qortonte shokun sepse këta murgjër flasin kështu prej padijes që kishin në religjionin e tyre – mendonte Ebu Sufjani. "Janë vetëm këta, thoshte Ebu Sufjani, që kanë nevojë për Profit për t'u spjeguar religjionin;

sa për ne, thoshte ai, ne kemi idhujt që na afrojnë te Zoti që t'i përulemi, prandaj s'kemi nevojë për asnjë Lajmëtar të ri. Është gjithashtu detyrë që ngarkohet mbi ne për t'a luftuar çdo bisedim si këtë ose që t'i përngajë këtë. Ebu Sufjani ishte i njohur si më i madhi Sycophante i Mekkës. Kishte të drejtë të fliste kështu, sepse ai fliste me atë fanatizmë dhe passion që kishte për Mekkën dhe për idhujtarinë e sajë, nuk e çmonte aspak se Ora e madhe e drejtimi po trokitte te dera, se Profetësija e Muhamedit (a.s.) po afrohej dhe se prej Arabisë idhujtare, që qe lënë fare pas dore, do të ndriçonte të tërë botën, pa ndryshim, Drita e Unitetit dhe Fjala e Vërtetë.

Gjenealogjia e H. Muhamedit a.s.

Duhet përmendur se nga trangu atëror, H. Muhamedi rrjedh si vijon: Është i Bir'i Abdull-llahut që qe lindur në 545 (M. K.), ky bir'i i Abdul Muttalibit që qe lindur në 497, ky bir'i Hashimit që qe lindur në 464, ky bir'i Abdi Menafit që qe lindur në 430, ky bir'i i Kusajit që qe lindur në 400.

Nga trangu nënor është bir'i i zonjës së madhe Aminë, kjo e bij'e Vehebit, ky i bir'i Abdi Menafit, ky i bir'i Zuhresë.

Abdull-llahu, mbasi qe martuar me Aminënë, qëndroi në shtëpinë e njerëzve të saj tri ditë, simbas zakonit t'arabëve kur bëhej martesë në shtëpinë e nuses. Kur u këthye në Mekkë në shtëpinë e t'atit (Abdul Muttalibit) së bashku me bashkëshorten, nuk qëndroi gjatë sepse shkoi për tregëti në Damask, duke e lënë të shoqen shtat-zanë. Më lart vendosëm se Abdull-llahu shkoi për tregëti në Damask. Përpara se të kapërcejmë e të përmendim lindjen e Profetit, le të përmendim një fakt tjetër historik; mbassi Abdull-llahu u vonua në udhëtimin e tij disa muaj në Oazze dhe me t'u kthyer prej udhëtimit, u ndal mysafir te dajat e vet në Medinë për t'u shlodhur prej udhëtimit të rëndë e të vështirë dhe për t'u kthyer pastaj me karvanin për Mekkë, ra i sëmurë në shtëpi të dajavet dhe shokët e lanë ashtu të sëmurë duke udhëtuar për Mekkë pa të. Kur arritën këtu, lajmëruanë t'atin për sëmundjen me të cilën ishte goditur i biri. Abdul Muttalibi pa humbur kohë dërgoi në Medinë djalin e madh, Harithin, për të marrë të vëllanë e për t'u këthyer së bashku me të në Mekkë. Por, kur Harithi arriu në Medinë, u lajmërua se Abdull-llahu kishte ndërruar jetë. Humbja e Abdull-llahut shkatoi dhimbje, mjerim e hidhërim të thellë tek Abdul Muttalibi sepse kishte humbur djalin më të zgjedhur të tij dhe duke pikëlluar e trishtuar zemrën e shpirtin e Aminesë për humbjen e një bashkëshorti, me të cilin shpresonte se do të kalonte një jetë të kënaqëshme dhe të lumtur.

Lindja e Muhamedit a.s.

Amineja shtat-zënë vazhdoi kështu edhe për një kohë të caktuar deri sa i erdh koha për të lindur. Kur lindi të birin i dërgoi Abdul Muttalibit në Qabe

myzhden se iu lind një nip. Plaku u gëzua kur mori lajmin e madh. Solli menjëherë ndër mend Abdull-llahun, duke ngushëlluar dhimbjen që ndjente për të me trashëgimtarin e tij të vocër. Shpejtoi te e reja, e mori djalin me zili midis dy duarvet, eci me të ashtu deri sa arriti në tempull (Qabe) dhe emëroi Muhamed! Sa do që ky emër nuk përdorej shumë prej arabët, ishte i njohur prej tyre. Pastaj gjyshi ia këtheu fëminë s'emës dhe mbet në pritje së bashku me të që të vijinë tajat që mëkojnë qumësht për t'ia dorëzuar njëres prej tyre, simbas zakonit të fisnikëve arabë të popullatës mekkase. Ai iu dorëzua kur ende ishte i njomë një gruajë beduine të quatur Halime, e fisit Beni Saëd. Kështu fëmija filloi të rritet në një atmosferë beduine, folës i gjuhës së tyre letrare. E ama e tij, Amineja, vdiq kur ai kishte arritur të gjashtin vit të jetës së tij.

H. Muhamedi u lind pra, prej dy prindërvet të vobegtë në pikpamje pasurije por të pasur në pikpamje fisnikërie dhe grade. Me gjithë këtë djemtë e Hashimit ishin kryetarë të Mekkës dhe mbikqyrshin pusin e zemzemit. Abdull llahu vdiq para se të lindi H. Muhamedi. Ky, mbasi lindi, mbeti nën mbrojtjen e gjyshit të tij, Abdul Muttalibit, por, kur edhe ky ndërroi jetë, e morri në dorëzim xhaxhai i tij Ebu Talibi.

H. Muhamedi qe lindur në 570 M. K., simbas mendimit të shumicës së historianëve. Ndërsa të tjerë e llogarisin se i Dërguari është lindur në 20 prill 571 M.K. Këtë mendim ka edhe i ndjeri Mahmud Pasha el Felekiu i Egjiptit. Ky vendos se Lindja e të Dërguarit ka ndodhë n'agimin e ditës së Hënë, në 9 të muajit Rebiul Evvel, vitin e Elefantit, që i përgjigjet 20 prillit të vitit 571 M. K.

Ibn Abbasi thotë se Muhamedi është lindur ditën e Elefantit. Të tjerë vëndosin se ai është lindur 15 vjet para ngjarjes s'Elefantit. Të tjerë përveç këtyre arrijnë të thonë se është lindur disa ditë pas Elefantit, ose disa muaj, ose disa vitëra; një tufë e llogarit këtë kohë në 30 vitëra, një tjetër në 70 vitëra.

Në të njëjtën mënyrë ranë në konflikt edhe për kohën në të cilën qe lindur, a u lind ditën apo natën, ashtu si ndryshojnë edhe se në cilin vend të Mekkës u lind. Caussin de Perceval, në librin e tij "Essai sur l'Histoire des Arabes" zgjedh që Muhamedi u lind në 20 gusht të vitit 570, d.m.th. Vitin e Elefantit, në Mekkë dhe në shtëpinë e gjyshit të tij Abdul Muttalibit.

Në të shtatën ditë të Lindjes së tij, Abdul Muttalibi urdhëroi të theren mishëra pastaj ftoi burrat e Kurejshivet, të cilët erdhën dhe hëngrën. Kur e morën vesh se e kishte emëruar me emërin e madh, Muhamed, e pyetën se përse hoq dorë prej emërave të gjyshërve dhe të stërgjyshërve të tij? U përgjigj: "Desha të jetë i lavdëruar në qiell ndaj Zotit si edhe në tokë prej krijesave të Tij".

**"Kultura Islame", Nr. 20-21, Prill-Maj 1941**

# XHAVIT ALIMEHMETI

## (1929-1997)

Lindi në Tiranë në vitin 1929 në një familje tiranase me traditë fetare intelektuale, të gjithë të shkolluar në Turqi dhe në Arabi. Prindërit u interesuan që edhe Xhavitin ta arsimojnë me kulturë fetare. Pasi mbaron arsimin bazë, prindërit e dërgojnë në Medresenë e Tiranës, e cila në kohën kur u arsimua Xhavit, ishte institucion i barasvlershëm me shkollën e mesme. Në këtë shkollë Xhavit diplomohet me rezultate të shkëlqyera duke përvetësuar shumë mirë gjuhën e huaj Arabisht. Pas përfundimit të shkollës emërohet nëpunës në administratën e Komunitetit Mysliman dhe vaiz në xhaminë e Kokonozit. I përkushtuar në punë, me një sjellje shembullore dhe aftësi të rrallë, fiton zemrat e të gjithëve, që për gjithçka i referoheshin Xhavitit. Si vaiz, me ligjëratat e tij tërheqëse dhe përshkrimet e motivuara nga gjuha arabe tërhuqi zemrat e besimtarëve që e prisnin me kënaqësi Xhavitin kur zinte vend në podiumin e predikuesit. Ai u bë njeriu më i besueshëm, teolog i afirmuar, që fjala e tij zinte vend në zemrën e çdo besimtari. Por aktiviteti i tij në shërbim të fesë islame do të ndërpritesh në vitin 1967, vit në të cilin feja ndalohet me ligj nga pushteti komunist. Zemra e Xhavitit u trishtua nga shkatërrimet që iu bënë Institucionit të Komunitetit Mysliman. Pajisja e Xhavitit me një kulturë të lartë dhe aftësitë e tij intelektuale bënë që Instituti i Historisë ta ftojë për të punuar pranë tij. Kontributi në këtë institut u vlerësua shumë sidomos përkthimi i dokumenteve të arkivit të Institutit nga gjuha arabe. Jo vetëm kaq, por Instituti hapi dhe kursin për arabisht të drejtuar nga Z. Xhavit Alimehmeti. Ai punoi në Institut deri në

vitin 1989 kur i erdhi fundi regjimit komunist dhe u vendos sistemi demokratik. Në karakteristikën që i bëri Instituti i Historisë vlerësimi të punës së Z. Xhavit Alimehmeti, theksohet: "Duke karakterizuar portretin e këtij njeriu kaq human, punëtor dhe të sinqertë, me plot gojën kemi të bëjmë me njeriun që Zoti vetë e ka përgatitur për të dhënë gjithçka duhej në këtë jetë. Kjo gatishmëri i buronte nga shpirti, nga edukata që kishte marrë nga shkolla e Medresesë që ai kishte mbaruar, por edhe nga edukata familjare e tij që trashëgonte".

Menjëherë, në fillimet e demokracisë, shtëpia e tij bëhet qendra e takimeve për krijimin e institucionit të Komunitetit Mysliman, që përfundoi me ceremoninë e hapjes së xhamisë së sahatit (Et'hem Beu). Xhavit emërohet Vaiz përsëri në xhaminë e Kokonozit dhe mësues në kursin e përgatitjes së imamëve për nevojat e ngutshme për imam xhamish. Në portretin e xhamisë si vaiz mishëroi dashuria për fenë islame, bujaria për të dhënë gjithçka për të, duke fituar respektin e të gjithë besimtarëve. Ai mishëronte virtyte të larta morale saqë admirohej e respektohej nga të gjithë pa dallim. Ai ishte i kudondodhur dhe i kudogjendur për të kontribuar në çështjet e Islamit. Por i tillë mbeti dhe për Institutin e Historisë ku në karakteristikë theksohet: "Edhe pse mbushi moshën e pensionit nuk u largua nga Instituti, por e mbajtën në punë sepse e gjykonin të nevojshëm rolin dhe shembullin e tij model për të gjithë". Ndahet nga jeta më 23.01.1997. Sot emri i tij kujtohet me respekt të thellë për veprën e tij, për shpirtin e madh, vlerat që ai mbarte, virtytet dhe mirësitë që ai rrezatonte.





# Sinjeriteti

## ZBUKURUESI I MARTESËS

Krijimi i familjes dhe ruajtja e saj kërkon sakrifica dhe shumë durim. Martesa bëhet edhe më e bukur kur burri dhe gruaja e bazojnë lidhjen e tyre në sinjeritet dhe besnikëri. Më poshtë kemi dhënë disa këshilla në lidhje me gjërat që duhen pasur parasysh para se të ndërmarrim vendimin e martesës dhe se çfarë duhet të presim konkretisht nga martesa.

Pike së pari duhet të jemi të vendosur sepse nëse nuk jemi të vendosur, nuk kemi dëshirën për të krijuar një familje atëherë ajo lidhje nuk ecën. Si gruaja ashtu dhe burri duhet të kenë si qëllim krijimin e një familjeje. Pasi i vëmë këtë qëllim vetes kalojmë në hapat e tjerë të cilët konsistojnë në zgjedhjen e personit me të cilin, lën do të krijojmë këtë familje. Sigurisht që zgjedhja e bashkëshortit /tes të ardhshëm nuk është e lehtë por çdo njeri ka parimet me të cilat krijon familje. Përputhshmëria e mendimeve të të dy palëve çon në një lidhje të shëndetshme. Besimi dhe sinjeriteti në një lidhje martesore nxisin dashurinë, respektin dhe tolerancën.

Shumë të rinj ndërmarrin hapin e martesës me shumë pritshmëri por ç'është më e rëndësishmja është dashuria dhe sinjeriteti në çift, besimi tek njëri tjetri, ndërveprimi në familje dhe përputhshmëria në mendime.

Përsa i përket pritshmërisë nga martesa do të themi që më mire është të mos kemi fare pritshmëri sepse kështu do të jemi më të qetë... qetësia nuk është diçka që arrihet e bazuar në një pritshmëri, nuk është e drejtë ta orientojmë veten me mendime si ta mbaroj shkollën, të hyj në punë dhe më pas të martohem, kështu do të arrij lumturinë.

Çdo njeri duhet të njohë mire veten para se të bëjë zgjedhjen e bashkëshortit/tes. Më e mira është të njohim

veten, të dime se çfarë na lumturon, sa fleksibël jemi ndaj të tjerëve, si përshtatemi dhe sa mund të tolerojmë në një lidhje. Nëse marrim përgjigje për këto pyetje atëherë mund të dime se çfarë kërkojmë nga pala përballë. Prandaj themi se më e rëndësishmja është njohja e vetes...

Nëse pyesim veten se cila është martesa ideale nuk është shumë e drejtë sepse martesa e çdokujt është e veçantë dhe unike në veten e saj dhe çdo njëri nga ne është heroi i historisë së tij. Njësia matëse e një martese besoj se është dëshira për ta vazhduar apo jo lidhjen. Nëse keni dëshirën do të gjeni gjithmonë një zgjidhje për çdo problem tuajin në çift por nëse kjo dëshirë nuk ekziston atëherë asgjë nuk vlen për ta vazhduar përpara.

Jo çdo familje është e mbushur me harmoni e dashuri, disa lidhje fillojnë me shumë dashuri por më pas hasin në probleme të ndryshme. Çfarë mund të bëjmë për të pasur një jetë familjare të qetë?

Të dy palët duhet të përputhen me njëri tjetrin, përputhshmëria në mendime, në formimin fetar e akademik, në statusin ekonomik e social luajnë një rol të rëndësishëm për një familje të shëndetshme. Mirëkuptimi dhe përshtatshmëria janë dy faktorë të tjerë të rëndësishëm. Mund të ndodhë që ju jeni mirëkuptues dhe përshtatni por pala tjetër nuk përshtatet dhe nuk ju mirëkupton. Në këtë rast përshtatshmëria juaj është e pamjaftueshme për krijimin e një lidhjeje të forte. Ju keni nevojë të mirëkuptoheni në mënyrë që të ruani energjinë tuaj positive. Një njeri i cili nuk mirëkuptohet nuk është i lumtur. Të mirëkuptohesh është sa e vështirë por aq edhe e thjeshtë, shumë çifte i hiperbolizojnë problemet dhe harrojnë se me një mirëkuptim të thjeshtë mund ti kishin zgjidhur ato.



Në çdo martesë duhen ruajtur kufinj të secilës palë. Asnjëra nga palët nuk duhet të çënojë të drejtën e palet tjetër. Çdo bashkëshort/e duhet të ruajë pozicionin përkatës në martesë. Më poshtë po rradhësim disa nga faktorët më të rëndësishëm në krijimin dhe ruajtjen e familjes:

**Sinqeriteti:** është forcuesi i bazave të martesës, një lloj përforcuesi i saj. Mendoni sikur keni hedhur themelin e një ndërtese dhe më pas keni nevojë për materiale tjera për ta vazhduar më tej. Ja pra edhe martesë ka nevojë për sinqeritetin për të vazhduar më gjatë dhe për t'u forcuar. Sinqeriteti është një siguresë e fortë jo vetëm e martesës por e gjithë marrëdhënieve ndërnjerëzore.

**Shëndeti:** është shumë i rëndësishëm si për anën fizike ashtu edhe për atë shpirtërore. Jeta seksuale është pjesë e pandarë nga martesë dhe natyra e njeriut. Kjo ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë me vazhdimin e familjes, ekuilibrimin dhe qetësinë e njerëzve.

**Dashuria:** asnjëherë nuk duhet të kursehem në dashuri por të japim më shumë se çmundemi. Martesë është e pamundur nëse në mes nuk ekziston lidhja e fortë e dashurisë mes dy partnerëve. Dashuria është si një margaritar i cili gjendet me shumë vështirësi por mund të humbasë shumë shpejt.

**Respekti:** në një vend ku ka respect ka dashuri dhe qetësi. Një njeri i respektuar vlerëson mendimet e bashkëshortes, nuk i kritikon apo nënvlerëson.

**Përgjegjësia:** Të mbash mbi supë përgjegjësinë që mbajti hz Nuh kur hipi njerëzit në anijen e shpëtimit. Të ndash me partnerin përgjegjësitë materiale dhe shpirtërore promovon një familje të kompletuar dhe fëmijë të shëndetshëm.

**Besnikëria:** pike së pari njeriu duhet t'i qëndrojë besnik Krijuesit të tij dhe më pas bashkëshortes së jetës. Një bashkëshort i drejtë në fjalë dhe vepra nxit një komunikim të drejtëpërdrejtë dhe një lidhje të fortë.

**Durimi:** të durosh siç duroi Haxherja r.a, të luftosh por fundin tja lësh në dorën e Zotit (xh.sh). Durimi është çelësi i kalimit të çdo problemi.

Te ruash të fshehtat: bashkëshortët duhet të jenë si një mburojë e fortë për të fshehtat e njëri tjetrit, të flasin për çdo gjë dhe të ndajnë çdo shqetësim apo frikë.

**Sinkronizimi:** sinkronizimi i bashkëshortëve është përputhshmëria mes tyre në shumë aspekte. Nëse ato pështaten lehtë me njëri tjetrin do ta kenë më të lehtë të ndajnë problemet mes tyre dhe t'i zgjidhin ato. Këtë mund ta mendojmë si të ngasësh biçikletën. Nëse e mbani mend kur ishim fëmijë biçikletën e mësonim me dy rrota ndihmëse derisa mësonim të mbanim ekuilibrin. E njëjta gjë ndodh edhe në martesë, Ne përballemi me situata me të cilat nuk dime si të veprojmë apo të ruajmë ekuilibrin. Kur ishim beqarë truri ynë ishte mësuar me një ekuilibër tjetër ndërsa kur martohemi trurit i duhet pak kohë derisa të përshtatet me jetën e re. Truri ka një aftësi të mahnitshme të përshtatshmërisë dhe bashkëshortët me anë të kësaj aftësie mësojnë të nisin biçikletën e martesës.

**Kufinj të:** secili prej nesh duhet të dijë kufinj të vet brenda familjes. Askush nuk mund të çënojë të drejtën apo kufirin e tjetrit. Për ta arritur këtë nuk duhet lexuar shumë, mjafton që secili të njohë veten dhe të respektojë personin përballë.

**Strehë:** familjet tona janë strehë të ngrohta e të sigurta tek të cilat mbrohem nga çdo rrezik ...

# Nenexhiku

## DHE VETITË E TIJ POZITIVE PËR SHËNDETI

Studimet e kryera kohët e fundit në lidhje me aromaterapinë tregojnë se aromat e mira mund të kenë efekte shumë pozitive në përmirësimin e gjendjes fizike dhe shpirtërore të njeriut. Shumë ekspertë të mjekësisë alternative në vendet perëndimore u përshkruajnë pacientëve të tyre mjekime me aroma të këndshme përveç mjekimit me medikamente. Më pak janë të njohura studimet mbi aromat e këqija. Një shumëllojshmëri e madhe bimësh janë të njohura për efektet e aromës së tyre dhe janë shumë të përdorura për mbrojtje, veçanërisht në vende me klimë të nxehtë dhe me lagështirë ku ka shumë insekte. Për shembull,

dihet që mushkonjat nuk afrohen nëse në shtëpi është mbjellë borzilok.

Një tjetër bimë e mirënjohur dhe gjerësisht e përdorur për aromën e saj është edhe nenexhiku (pogostemoncablin). Ai është pjesë e familjes së mentes dhe origjina e tij është India. Aroma e saj mund të gjendet në bojën e famshme të Indisë dhe në vajrat e përftuar nga zierja dhe përpunimi i nenexhikut. Gjethet e nenexhikut vendoseshin midis qilimave ose sixhadeve të Iranit dhe Turqisë për t'i mbrojtur nga insekte dhe parazitë të ndryshëm përpara se të dërgoheshin për në Europë. Gjatë epokës viktoriane, qilimat, rrugicat e eksportuara

nga India spërkatëshin me vajin e nenexhikut për t'i mbrojtur edhe nga myku.

Në fakt, të gjithë këto prodhime, nëse nuk ishin të ruajtura me enët e aromës së nenexhikut nuk ishin të sigurta sepse mendohej se nuk ishin prodhuar në Lindje, por në Europë. Aroma e nenexhikut, e cila është më e forta dhe që zgjat më shumë se të tjerat, besohet nga kinezët, japonezët dhe arabët se parandalon përhapjen e sëmundjeve infektive dhe është gjerësisht e përdorur në parfume dhe detergjente. I përdorur masivisht në Europën e shekullit të 18, nenexhiku u shndërrua në bimën më popullore të gjeneratave të mëpasme në Amerikën e viteve '60.

Kërkimet mbi nenexhikun kanë qenë të kufizuara për shumë kohë dhe vëzhgimet shkencore janë të pamjaftueshme. Sidoqoftë, përbërja kimike e aromës së vajit të kësaj bime është identifikuar dhe përvoja e gjatë njerëzore e përdorimit të saj mbart në vetvete një domethënie të madhe për kërkimet që mund të kryhen në të ardhmen.

Nenexhiku përmban alkool bimor, pogostone, friedelin, epifriedelinol, pakipodol, retusin, acid oleanolik, beta-sitosterol dhe daukosterol, shumica e të cilëve parandalojnë të vjellat dhe nauzenë. Gjithashtu është vënë re se ai përmban alfa-bulnesene, i cili parandalon mpiksjen e gjakut. Për më tepër, sipas një artikulli të muajit shkurt 2008 të revistës shkencore Fitoterapia, meqë aroma e vajit të nenexhikut është një vrasës i mirë i insekteve, ai mund të përdoret si një përbërës në preparatet kundër insekteve të dëmshme dhe parazitëve.

Duke përfutur nga këto studime, shohim se fushat e përdorimit të nenexhikut janë të shumta. Për shembull, duke shtuar disa pika vaj nenexhiku në një enë me ujë në shtëpi, ta vendosim diku ose të spërkasim shtëpinë me të për të larguar aromat e këqija dhe njëkohësisht për të larguar insektet e bezdisshme. E gjithë kjo realizohet shumë lehtë dhe nuk kemi pse të përdorim insekticide kimikate kancerogjene. Vaji gjithashtu ka efekte kundër mykut të lëkurës, eliminon erën e keqe të djersës dhe mund të përdoret edhe për qëllime dietetike sepse pakëson oreksin.

Kohët e fundit është zbuluar edhe një veti tjetër e nenexhikut që është ajo e efekteve pozitive mbi gjendjen emocionale dhe shpirtërore. Martin Henglein, i cili është një nga themeluesit e aromaterapisë dhe përkrahës i teorisë se kurës me anë të aromës së bimëve sigeranium, rozmarinë, bergamot dhe nenexhikut, si 4 aromat primare esenciale, të cilat kanë efekte mbi shëndetin e njeriut. Geraniumi mund të parandalojë varësinë nga substancat dhe të ndihmojë në braktisjen e veseve të dëmshme. Për shembull, roli që geraniumi luan në lënien e duhanit është i padiskutueshëm. Në momentin kur dëshira për të pirë duhan është e madhe, aroma e geraniumit e largon këtë dëshirë përkohësisht. Sipas Henglein,

rozmarina përmirëson kujtesën, ndërsa bergamoti rrit aktivitetin e trurit dhe aftësinë e të kuptuarit, ndërsa nenexhiku aktivizon mekanizma që motivojnë energjinë e brendshme të njeriut.

Robert Tisserand, pronari i një qendre trajtimi në Angli, beson se disa aroma mund të kurojnë madje edhe sëmundje mendore e psikologjike. Tisserand thotë se këto aroma kanë efekte pozitive mbi molekulat sinjalizuese (neurotransmetues) që janë ndërlidhëse të qelizave nervore. Aromat e tilla stimulojnë organizmin të çlirojnë endorfina, substanca që ngjajnë me morfienë (lehtësues i dhimbjes) dhe për këtë vaji i trëndafil, jaseminës, sage, cananga (ylangylang), nenexhikut dhe grapefruit janë të rekomanduar në trajtimin e depresionit, për të rritur vetëbesimin dhe për të ndihmuar anomalitë e funksioneve seksuale. Nëse nenexhiku përdoret me tepriçë atëherë ai mund të shkaktojë efekte gjumëdhënëse ose e kundërta. Përveç të tjerash ai ka efekt ekuilibruës mbi energjinë trupore dhe gjendjen psikologjike, jep një ndjenjë qetësie, largon dembelizmin, largon depresionin dhe ankthin.

Tashmë është e qartë se aromat e mira kanë shumë dobi për shëndetin e njeriut, mbi ndjenjat dhe mendimet, po ashtu dihet edhe efekti negativ i aromave të këqija. Në një hadith Profeti Muhamed, paqja qoftë mbitë, pathënë: "Më janë bërë të dashura aromat e mira", duke tërhequr vëmendjen te rëndësia e erërave të mira dhe duke na kujtuar se Jakubi a.s. mori lajme të mira për të birin e tij Jusufin vetëm nga era e këmishës së tij.

**Përktheu: Erion Sukaj**

## Referenca

Guan L, Quan LH, Xu LZ, Cong PZ. (1994): Chemical constituents of Pogostemoncablin (Blanco) Benth. Zhongguo Zhong Yao Za Zhi. 1994 Jun;19(6):355-6, 383.

Yang Y, Kinoshita K, Koyama K, Takahashi K, Tai T, Nunoura Y, atanabe K.(1999): Anticemetic principles of Pogostemoncablin (Blanco) Benth. Phytomedicine. 1999 May, 6 (2): 89-93.

Luo J, Guo X, Feng Y. (2002): Constituents analysis on volatile oil of Pogostemoncablin from different collection time cultivated in Hainan. Zhong Yao Cai. 2002 Jan. 25 (1): 21-3.

Hsu HC, Yang WC, Tsai WJ, Chen CC, Huang HY, Tsai YC. (2006): Alpha-bulnesene, a novel PAF receptor antagonist isolated from Pogostemoncablin. BiochemBiophys Res Commun. 2006 Jul 7;345(3):1033-8.

Tsai YC, Hsu HC, Yang WC, Tsai WJ, Chen CC, Watanabe T. (2007): Alpha-bulnesene, a PAF inhibitor isolated from the essential oil of Pogostemoncablin. Fitoterapia. 2007 Jan. 78 (1):7-11.

Pavela R. (2008): Insecticidal properties of several essential oils on the house fly (*Musca domestica* L.). Phytother Res. 2008 Feb;22(2):274-8.

Jantan, I. and Zaridah M. Z.(1999): Development of Environment-Friendly Insect Repellents From The Leaf Oils of Selected Malaysian Plants. ASEAN Review of Biodiversity and Environmental Conservation (ARBEC) November-December 1999, p. 1-7.

# Omeri bujar

Një njeri i varfër nuk po e paguante që nuk e po paguante dot borxhin prej nëntë mijë florinjsh. Në Tebriz jetonte një njeri shumë i pasur dhe tejet bujar që e quanin Bedretin Omer.

Të gjithë të varfrit, kur ziheshin keq, tek ai shkonin si fillim për t'i kërkuar ndihmë. As ai nuk ishte të dëgjuar që të kthente kënd mbrapsht dhe duarbosh. Ai i ndihmonte të gjithë me aq sa kishte mundësi. I varfri, që mësoi për këtë cilësi të vyer të Omerit, vendosi që të shkonte njëherë tek ai për të kërkuar ndihmesë. Sakaq ai filloi të kërkonte për vendin ku jetonte njeriu bujar.

I gjori besonte me një fuqi të pazakontë dhe pa kurrfarë dyshimi tek ndihma e Omerit për të shpëtuar prej borxhit që po e treste pak e nga pak. Më në fund, ai e gjeti shtëpinë e Bedretinit, mirëpo të afërmit e tij i treguan se Omeri kishte vdekur.

Burri, tashmë krejtësisht i pashpresë, lëshoi një ulërimë duke i rënë të fikët. Njerëzit përreth u munduan që ta nxirrin nga të fikët duke i derdhur lëng trëndafili në fytyrë. Të gjitha shpresat e mëdha që ai kishte, kishin vdekur tashmë për burrin e mjerë.

Ndihmësi i Bedretin Omerit, me të dëgjuar për hallin që e kishte kapluar këtë burrë, megjithëse

u përpoq të mblidhte ndihma nga gjindja për ta ndihmuar, prapëseprapë nuk mundi të bënte asgjë.

I varfri dhe ndihmësi i Bedretin Omerit u nisën të dy tok për në varrin e tij, që të bënin lutje për shpirtin e atij njeriu të veçantë. Të dy burrat, u kthyen më në fund në shtëpinë e ndihmësit, pa gjetur asnjë zgjidhje, dhe pasi hëngrën darkë, u shtrinë të lodhur që të bënin një sy gjumë. Ndihmësi i Omerit pa në ëndërr zotërinë e tij.

Bedretini ishte mërëzitur shumë dhe donte që ky njeri i mjerë të ndihmohej medoemos. Kështu që Omeri i tregoi atij vendin ku kishte fshehur një pjesë të mirë të pasurisë duke i kërkuar që me to të paguhej me patjetër borxhi që shqetësonte atë njeri të mjerë e në pikët të hallit.

Një të aguar, ndihmësi i Bedretin Omerit shkoi në vendin që e kishte drejtuar zotëria i tij. Atje ai gjeti pasuri të pallogaritshme. Mandej, ai shiti një pjesë të tyre, me paratë e të cilave ai pagoi borxhin që rëndonte sa në kurizin e atij njeriu të gjorë, aq edhe në shpirtin e një njeriu bujar si Omeri.

"Pasuria nuk pakësohet aspak duke dhënë lëmshë, sepse të bërit mirë, e ruan pasurinë prej humbjes dhe pakësimit."






**BOTIMET KMSH**

# KALENDARI 2023

1444 - 1445 HIXHRI



| JANUAR | DIETËT | XII. AHIRE |       |       |       |       |
|--------|--------|------------|-------|-------|-------|-------|
| 1      | D.     | 9          | 05:23 | 07:01 | 11:55 | 18:04 |
| 2      | H.     | 10         | 05:23 | 07:01 | 11:56 | 18:05 |
| 3      | M.     | 11         | 05:23 | 07:01 | 11:56 | 18:06 |
| 4      | M.     | 12         | 05:23 | 07:01 | 11:56 | 18:07 |
| 5      | E.     | 13         | 05:23 | 07:01 | 11:56 | 18:07 |
| 6      | P.     | 14         | 05:23 | 07:01 | 11:56 | 18:07 |
| 7      | SH.    | 15         | 05:23 | 07:01 | 11:56 | 18:07 |
| 8      | D.     | 16         | 05:23 | 07:02 | 11:57 | 18:08 |
| 9      | H.     | 17         | 05:23 | 07:01 | 11:57 | 18:09 |
| 10     | M.     | 18         | 05:23 | 07:01 | 11:55 | 18:04 |
| 11     | M.     | 19         | 05:22 | 07:01 | 11:56 | 18:05 |
| 12     | E.     | 20         | 05:22 | 07:01 | 11:56 | 18:06 |
| 13     | P.     | 21         | 05:22 | 07:00 | 11:56 | 18:07 |
| 14     | SH.    | 22         | 05:22 | 07:00 | 11:57 | 18:08 |
| 15     | D.     | 23         | 05:22 | 07:00 | 11:57 | 18:09 |
| 16     | H.     | 24         | 05:22 | 07:00 | 11:57 | 18:09 |
| 17     | M.     | 25         | 05:22 | 07:00 | 11:57 | 18:09 |
| 18     | M.     | 26         | 05:22 | 07:00 | 11:57 | 18:09 |
| 19     | E.     | 27         | 05:22 | 07:00 | 11:57 | 18:09 |
| 20     | P.     | 28         | 05:22 | 07:00 | 11:57 | 18:09 |
| 21     | SH.    | 29         | 05:22 | 07:00 | 11:57 | 18:09 |
| 22     | D.     | 30         | 05:22 | 07:00 | 11:57 | 18:09 |
| 23     | H.     | 1          | 05:19 | 06:56 | 11:59 | 18:16 |
| 24     | M.     | 2          | 05:18 | 06:55 | 11:59 | 18:16 |
| 25     | M.     | 3          | 05:18 | 06:54 | 12:00 | 18:17 |
| 26     | E.     | 4          | 05:17 | 06:54 | 12:00 | 18:19 |
| 27     | P.     | 5          | 05:17 | 06:53 | 12:00 | 18:20 |
| 28     | SH.    | 6          | 05:16 | 06:52 | 12:00 | 18:21 |
| 29     | D.     | 7          | 05:16 | 06:52 | 12:00 | 18:22 |
| 30     | H.     | 8          | 05:15 | 06:51 | 12:01 | 18:23 |
| 31     | M.     | 9          | 05:15 | 06:50 | 12:01 | 18:23 |
|        |        |            | 05:14 | 06:49 | 12:01 | 18:24 |
|        |        |            | 05:13 | 06:49 | 12:01 | 18:25 |
|        |        |            | 05:13 | 06:49 | 12:01 | 18:26 |

DURRËS -2\*, SHKODER -2\*, VLORE +1\*, LUSHNJË +1\*, BERAT 0\*, ELBASAN -1\*, KUKËS -1\*, PESH-KOPI -2\*, LIBRAZH -2\*, KORÇE -3\*

Shënim: Dita e re sipas Kalendarit Hëncy filon pas namazit të Aksharit.  
23.01.2023 (e hënë) - Filimi i 3 Muajve të Mirë.  
26.01.2023 (e enjte) - Nata e Mirë e parë - Regabi.